

**URDHËR**  
**Nr. 102 datë 5.2.2019**

**PËR ZBATIMIN E PLANIT SHUMËVJEÇAR TË MENAXHIMIT TË TONIT TË KUQ  
NË ATLANTIKUN LINDOR DHE DETIN MESDHE**  
**[REC. ICCAT 18 – 02]**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, i ndryshuar; të pikave 1 dhe 2, të nenit 8, të Konventës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut (ICCAT), të miratuar me ligjin nr. 9822, datë 29.10.2007, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut (ICCAT)”;

**URDHËROJ:**

1. Zbatimin e planit shumëvjeçar të menaxhimit të tonit të kuq në Mesdhe dhe në Atlantikun Lindor të Komisionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut (ICCAT), të përcaktuar nga Rekomandimi ICCAT [REC. 18-02], që i bashkëngjitet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Sektori i Politikave të Peshkimit dhe Akuakulturës, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e pikave 4-7, 10-12, 14-20, 29, 34, 37-38, 48-54, 57-62, 69-72, 74-77, 79, 81-82, 87-88, 90, 105, 109, 117, 119 dhe shtojcat 1-2 dhe 6-11.

3. Ngarkohet Inspektorati i Peshkimit në Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës për zbatimin e pikave 41-44, 106, 108 dhe shtojcën 11.

4. Kapitenët e anijeve të peshkimit zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga pikat 63-66, 68, 73, 78, 80, 86, 89 dhe shtojcat 3-5.

5. Pikat e tjera të Rekomandimit [18-02] të papërmendura në pikat 2-4 të këtij urdhri, janë detyruese për institucionet e mësipërme, në zbatim të shkronjës a), pika 1, të nenit 8, të Konventës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut (ICCAT), të miratuar me ligjin nr. 9822, datë 29.10.2007, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut (ICCAT), në rast se Shqipëria do të zhvillojë aktivitetet e rregulluara sipas këtyre pikave.

6. Peshkimi i tonit të kuq do të kryhet gjatë periudhës prej 26 majit, deri më 1 korrik 2019 vetëm me mjetet lundruese që përdorin formën e peshkimit me koshlok (me rrethim) sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 719, datë 12.10.2016, “Për menaxhimin e kapaciteteve të peshkimit tregtar dhe disa rregullime të mënyrës së funksionimit të regjistrit të anijeve të peshkimit”.

7. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, urdhri nr. 74 datë 14.02.2018, “Për zbatimin e planit shumëvjeçar të rimëkëmbjes së tonit të kuq në Mesdhe dhe Atlantikun Lindor të ICCAT [REC. 17-07]”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQESISE  
DHE ZHVILLIMIT RURAL  
**Bledar Çuçi**

**REKOMANDIMI I ICCAT [18-02]**  
**PËR HARTIMIN E**  
**NJË PLANI MENAXHIMI SHUMËVJEÇAR PËR**  
**TONIN E KUQ NË ATLANTIKUN LINDOR DHE DETIN MESDHE**

*Duke pranuar* që Komiteti i Përhershëm për Kërkime dhe Statistika (Standing Committee on Research and Statistics), në këshillimin e tij të vitit 2017, vuri në dukje se Totali i Zënieve të Lejuara (Total Allowable Catch) mund të vendoset në nivelin 36,000 t, nivel që do të arrihet në vitin 2020 me hapa gradualë, pa dëmtuar suksesin e planit të rimëkëmbjes;

*Duke pranuar* këshillën e SCRS-së për të konsideruar kalimin nga plani aktual i rimëkëmbjes në një plan menaxhimi dhe se statusi aktual i stokut nuk ka nevojë për masa emergjente të paraqitura në kuadrin e planit të Rimëkëmbjes për tonin e kuq në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe (Rekomandimi 17-07 nga ICCAT-i, që ndryshon Rekomandimin 14-04);

**Duke pranuar** paragrafin 4 të Rekomandimit Rec. 17-07, ku thuhet se Komisioni do të krijojë një plan-menaxhim për stokun në vitin 2018;

**Duke marrë parasysb** se **SCRS**-ja po zhvillon një proces të vlerësimit të strategjisë së menaxhimit (**Management Strategy Evaluation**), me synimin të vlerësojë procedurat e ndryshme të menaxhimit të cilat janë të qëndrueshme për burimet kryesore të pasigurisë dhe se procesi i **MSE**-së pritet të ofrojë procedura kandidatë të menaxhimit në terma afatshkurtër, por jo afatshpejta (p.sh., nga 2021-2022), përzgjedhja e procedurës së dëshiruar të menaxhimit nga Komisioni merr pak kohë. Prandaj, është propozuar që të ketë një objektiv të përkohshëm të menaxhimit, që mund të rishikohet në kohën kur Komisioni miraton rregullat e kontrollit të zënieve (**Harvest Control Rules**). Në këtë kontekst, Komisioni mund të vendosë që nga viti 2020 për ndryshimet në kuadrin e menaxhimit për tonin e kuq në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe, siç këshillohet nga **SCRS**-ja, në bazë të vlerësimit të fundit të rezervave dhe në bazë të rekomandimeve të mëtejshme të menaxhimit të mbështetura nga Vlerësimi i Strategjisë së Menaxhimit (**MSE**) dhe pas procedurës së menaxhimit, duke përfshirë **HCR**-të, të përcaktuara nga **SCRS**-ja.

**Duke pranuar më tej** ndikimet e planit të rimëkëmbjes së tonin të kuq në flotën e peshkimit artizanal në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe, sidomos në lidhje me reduktimin e kapacitetit të peshkimit;

**Duke marrë parasysb** kapacitetin e stokut për t'u përgjigjur rekrutimit të ulët në disa vite të njëpasnjëshme, kjo do të jetë e rëndësishme për të siguruar që kapaciteti i peshkimit të mbetet brenda kufijve të qëndrueshëm dhe se kontrolli i kapacitetit mbetet efektiv;

**Duke marrë në konsideratë** rëndësinë e ruajtjes së qëllimit dhe integritetit të masave të kontrollit dhe përforcimin e gjurmueshmërisë së zënieve, veçanërisht në lidhje me transportin e peshqve të gjallë dhe aktiviteteteve në fermat e rritjes;

**KOMISIONI NDËRKOMBËTAR  
PËR KONSERVIMIN E TONIT  
TË ATLANTIKUT (ICCAT)  
REKOMANDON QË:**

**Pjesa I**

**Dispozitat e përgjithshme**

**Objektivi**

1. Palët kontraktuese dhe palët bashkëpunuese jo-kontraktuese, subjektet ose entitetet e peshkimit referuar me poshtë si CPCs, anijet e të cilave kanë peshkuar në mënyrë aktive tonin e kuq (*Thynnus thynnus*) në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe do të zbatojnë një plan menaxhimi për tonin e kuq në atë zonë gjeografike duke filluar në vitin 2019 me qëllim të ruajtjes së biomasës rreth B 0.1, arritur nga peshkimi në ose më pak se F 0.1, të cilin **SCRS**-ja e konsideron si numër të arsyeshëm për **FMSY**-n.

Ky objektiv do të rishikohet dhe modifikohet, nëse është e nevojshme, kur Vlerësimi i Strategjisë së Menaxhimit tregon progres të dukshëm, kur objektivat alternative të menaxhimit mund të merren parasysb dhe pikët e referencës, rregullat e kontrollit të zënieve dhe/ose procedurat e menaxhimit mund të adoptohen.

2. Kur vlerësimi i stokut nga **SCRS**-ja tregon se statusi dhe zhvillimi i tij (në terma të biomasës dhe/ose mortalitetit nga peshkimi) devijon nga objektivi, do të aplikohen klauzolat e masave të sigurisë dhe rishikimit siç përcaktohen në dispozitat përfundimtare të këtij plani.

**Përkufizimet**

3. Në kuptim të këtij plani:

a) "Anije peshkimi" është çdo anije e përdorur për qëllimin e shfrytëzimit për qëllime komerciale të resurseve të tonit të kuq, duke përfshirë anijet peshkuese, anijet përpunuese të peshkut, anijet mbështetëse, anijet rimorkiuese, anijet që aktivizohen në proceset e transbordimit dhe anijet e transportit të pajisura për transportimin e prodhimeve të tonit dhe anijet ndihmëse, përjashtuar anijet kontejner.

b) "Anije peshkuese" është një anije e përdorur me synim zënien për arsye tregtie të resurseve të tonit të kuq.

c) "Anije përpunuese" është një anije, në bordin e së cilës, para se prodhimi të paketohej, mund të ndodhin një ose disa aktivitetet e mëposhtme: filetimi apo prerja në feta, ngrirja dhe/ose përpunimi.

- d) “Anije ndihmëse” është çdo anije që përdoret për transportimin e individëve jo të gjallë të tonit të kuq (jo të përpunuar) nga koshat e transportit/rritjes, nga një koshilok apo kurth në një port të përcaktuar/ose në një anije përpunimi.
- e) “Anije rimorkimi/tërheqëse” nënkupton çdo anije që përdoret për tërheqjen e koshave.
- f) “Anije mbështetëse” do të thotë çdo anije tjetër e peshkimit e referuar sipas pikës 3a).
- g) “Peshkimi në mënyrë aktive” do të thotë, për çdo anije peshkuese, që faktikisht synon të peshkojë tonin e kuq gjatë një sezoni të caktuar peshkimi.
- h) “Operacion i përbashkët i peshkimit” (referuar në tekst si JFO) nënkupton çdo operacion midis dy ose më shumë anijeve me koshilok, ku zënia e një anijeje me koshilok i atribuohet një ose më shumë anijeve të tjera me koshilok në përputhje me çelësin e shpërndarjes.
- i) “Operacion transferimi” nënkupton:
- çdo transferim të individëve të gjallë të tonit të kuq nga rrjeta e anijes peshkuese në koshin transportues;
  - çdo transferim të individëve të gjallë të tonit të kuq nga një kosh transportues në një kosh tjetër transportues;
  - çdo transferim të koshave me ton të kuq nga një anije tërheqëse në një tjetër anije tërheqëse;
  - çdo transferim të tonit të kuq të gjallë nga një fermë rritjeje në një tjetër, ose midis koshave të ndryshëm në të njëjtën fermë;
  - çdo transferim të tonit të kuq të gjallë nga një kurth në koshin transportues pavarësisht nga prania e një anije tërheqëse.
- j) “Kontrolli i Transferimit” nënkupton çdo transferim shtesë që zbatohet me kërkesë të operatorëve të peshkimit/të rritjes ose autoriteteve të kontrollit me qëllim verifikimin e numrit të peshqve që transferohen.
- k) “Kurth toni” është një vegël fikse peshkimi e ankoruar në fund dhe që zakonisht përmban një rrjetë udhëzuese që çon tonin e kuq në një mbyllje ose seri mbylljesh ku mbahet para kapjes ose mbarështimit.
- l) “Kurth CPC” do të thotë CPC-ja ku një kurth i tonit të kuq është instaluar në ujërat nën juridiksionin e tij.
- m) “Vendosja në kosha” nënkupton zhvendosjen e tonit të kuq të gjallë nga kurthet apo koshat e transportit te koshat e majmërisë apo koshat e kultivimit.
- n) “Majmëri” ose “kultivim” do të thotë mbajtja në kosha e tonit të kuq dhe ushqimi i vazhdueshëm i tij që ka për qëllim shëndosjen dhe rritjen e biomasën së tyre totale.
- o) “Fermë” nënkupton një zonë detare të përcaktuar qartë me koordinata gjeografike, e përdorur për majmëri apo kultivim të tonit të kuq të kapur me kurthe dhe/ose me koshilok. Një fermë mund të ketë disa vendvendosje, të gjitha të përcaktuara me koordinata gjeografike (me një përkufizim të qartë të gjatësisë dhe gjerësisë gjeografike për çdo një nga pikat e poligonit).
- p) “Vjelje” nënkupton vrasjen e tonit të kuq në ferma apo në kurthe.
- q) “Transpordim” nënkupton shkarkimin e të gjithë ose të ndonjë peshku nga bordi i një anijeje peshkimi në një anije tjetër peshkimi. Megjithatë, shkarkimi i tonit të kuq të ngordhur nga koshiloku, kurthi ose anija rimorkiuese/tërheqëse në një anije ndihmëse nuk do të konsiderohet si transbordim.
- r) “Peshkimi sportiv” është peshkimi jo me qëllim tregtar, anëtarët e të cilit bëjnë pjesë në një organizatë kombëtare sportive ose janë të pajisur me një licencë kombëtare sportive.
- s) “Peshkim çlodhës/argëtues” është peshkimi jo me qëllim tregtar, anëtarët e të cilit nuk bëjnë pjesë në një organizatë kombëtare sportive ose nuk janë të pajisur me licencë kombëtare sportive.
- t) “Kamera stereoskopike” do të thotë një aparat fotografik me dy ose më shumë lente, me një sensor të veçantë imazhi ose kornizë filmi për çdo lente, duke bërë të mundur marrjen e imazheve tredimensionale me qëllim për të matur gjatësinë e peshkut.
- u) “Kamera kontrolli” nënkupton një aparat stereoskopik dhe/ose video-kamera konvencionale për qëllime të kontrolleve të parashikuara në këtë Rekomandim.
- v) “BCD-ja ose BCD-ja elektronike” nënkupton një dokument zënieje të tonit të kuq. Sipas rastit, referenca për BCD-në, do të zëvendësohet nga e-BCD.
- w) Gjatësitë e anijeve të referuara në këtë Rekomandim duhet të kuptohen si gjatësi të përgjithshme.
- x) “Anije e peshkimit të vogël bregdetar”, në kuptim të këtij rekomandimi, është një anije me të paktën tre nga pesë karakteristikat e mëposhtme:
- gjatësi të përgjithshme <12 m;
  - anija ushtron peshkimin ekskluzivisht brenda ujërave territorialë të flamurit CPC;

- daljet e saj të peshkimit të kenë një kohëzgjatje prej më pak se 24 orësh,
- numri maksimal i ekuipazhit është i përbërë me katër persona, ose
- anija përdor mjete peshkimi selektive, të cilat kanë një ndikim të ulët në mjedis.

y) “Kosha kontrolli” nënkupton çdo kosh shtesë që vendoset me kërkesë të operatorëve të peshkimit/rritjes ose autoriteteve të kontrollit me qëllim të verifikimit të numrit dhe ose peshës mesatare të peshkut që është kapur.

## Pjesa II Masat menaxhuese

TAC-i (zëniet totale të lejuara) dhe kuotat dhe kushtet e lidhura me ndarjen e kuotave për CPCs.

4. Çdo CPC duhen marrë masat e nevojshme për të siguruar që sforcio e peshkimit, nga anijet e peshkimit dhe kurthet e tij, të jenë në përputhje me mundësitë e peshkimit të tonit të kuq në dispozicion të këtij CPC në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe, duke përfshirë vendosjen e kuotave individuale për anijet e peshkimit me gjatësi mbi 24 m përfshirë në listën e përmendur në paragrafin 49, pika a), të këtij Rekomandimi.

5. Zëniet totale të lejuara (TACs), përfshirë hedhurinat e ngordhura (discards), për vitet 2019-2020 do të jenë: 32,240 t për 2019 dhe 36,000 t për vitin 2020, në përputhje me skemën e kuotës në vijim:

CPC	Kuota 2019 (t)	Kuota 2020 (t)
Shqipëria	156	170
Algjeria	1,446	1,655
Kina	90	102
Egjipti	266	330
Bashkimi European	17,623	19,460
Islanda*	147	180
Japonia	2,544	2,819
Koreja	184	200
Libia	2.060	2,255
Maroku	3	3,284
Norvegjia	239	300
Siria	73	80
Tunizia	2.400	2655
Turqia	1.880	2305
Kina Taipie	84	90
Total	32,140	35,885
Rezerva të paalokuara	100	115
Total	32,240	36,000

\* Pavarësisht nga dispozita e kësaj pjese, Islanda mund të kapë përtej sasisë së kuotës çdo vit me 25% ndërsa kapja e saj totale për 2018-n, 2019-n dhe 2020-n nuk duhet të kalojë 411 t (84 t + 147 t + 180 t).

Kjo tabelë nuk do të interpretohet që të ketë ndryshuar çelësat e shpërndarjes të paraqitura në Rekomandimin 14-04. Hapat e tjerë do të bëhen në të ardhmen nga Komisioni.

Mauritania mund të peshkojë deri në 5 t për kërkime çdo vit, në qoftë se ata respektojnë rregullat e raportimit të zënieve të përcaktuara në këtë Rekomandim. Zëniet do të zbriten nga rezervat e pashpërndara.

TAC-i do të rishikohet çdo vit sipas këshillës së SCRS-së.

Në varësi të disponueshmërisë, Kina Taipie mund të transferojë deri në 50 t dhe 50 t të kuotave të saj në Kore në vitet 2019 dhe 2020, respektivisht.

6. CPC flamur mund t'i kërkojë një anijeje peshkimi të kthehet menjëherë në një port të përcaktuar prej tij, kur kuota individuale konsiderohet e peshkuar/mbaruar.

7. Nuk lejohet mbartja e kuotave të papërdorura. Një CPC mund të kërkojë të transferojë një

maksimum prej 5% të kuotës të vitit 2019 në vitin 2020. CPC do të përfshijë këtë kërkesë në planin e tij të peshkimit/të kapacitetit që miratohet nga Komisioni, në përputhje me paragrafin 15.

8. Mbartja e kuotës së tonit të gjallë të pazënë nuk është i autorizuar nëse nuk zbatohet një sistem i përforcuar kontrolli dhe i raportohet Sekretariatit të ICCAT si pjesë integrale e planit të monitorimit, kontrollit dhe inspektimit të paraqitur sipas paragrafit 14 të këtij Rekomandimi. Një sistemi i tillë i përforcuar duhet të përfshijë së paku dispozitat e përcaktuara në paragrafët 54, 103 dhe 107. Masat e mëtejshme të kontrollit do të shqyrtohen në një takim intersezional të Panelit 2 si referohet në paragrafin 116.

9. CPC që kanë ferma rritjeje sigurojnë që, para fillimit të sezonit të peshkimit, të bëhet një vlerësim i plotë i çdo sasi toni të gjallë të mbartur pas grumbullimit të pjesës më të madhe në fermat nën juridiksionin e tyre. Për këtë qëllim, të gjitha sasitë e mbartura të tonit të gjallë prej zënieve gjatë një viti (d.m.th. peshqit që nuk janë subjekt i vjeljeve në pjesën më të madhe në ferma) do të transferohen në kosha të tjerë duke përdorur sistemin e kamerave stereoskopike ose metoda alternative me kusht që ato të garantojnë nivel saktësie dhe precizion. Mbartja e tonit që nuk është subjekti i vjeljes gjatë viteve, do të kontrollohet çdo vit duke përdorur të njëjtën procedurë të vlerësimit të riskut.

Gjatë gjithë kohës duhet të sigurohet gjurmimi i plotë i peshqve të mbartur. Masat që sigurojnë këtë duhet të jenë plotësisht të dokumentuara.

10. Transferimi i kuotave ndërmjet CPC-ve bëhet vetëm me autorizim nga CPC-të në fjalë. Ato transferime të pranuar nga CPC-të në fjalë duhet t'i komunikohen Sekretariatit të paktën 48 orë përpara hyrjes në fuqi të tyre.

11. Nuk lejohet asnjë veprim i marrjes, dhënies me qira (*chartering*) për peshkimin e tonit të kuq.

12. Nëse zëniet e një CPC në ndonjë vit tejkalojnë sasitë e përcaktuara, CPC duhet të pakësojnë atë sasi në vitin e ardhshëm, në përputhje me dispozitat në paragrafët 2 dhe 3 të ICCAT Rekomandimit 96-14.

13. SCRS do të vazhdojë punën për MSE, testimin e procedurave të menaxhimit, duke përfshirë edhe rregullat e kontrollit të vjeljeve (HCRs), të cilat duhet të mbështesin objektivat e menaxhimit që do të miratohen nga Komisioni në vitin 2019. Bazuar në të dhënat dhe këshillat e SCRS dhe të një proces dialogu mes shkencëtarëve dhe menaxherëve, Komisioni do të përpiqet në vitin 2020 për të miratuar një procedurë të menaxhimit për rezervat e tonit të kuq në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe, duke përfshirë veprime menaxhuese të miratuara më parë që do të ndërmerren sipas kushteve të ndryshme të rezervave të tonit.

**Dorëzimi i planeve vjetore të peshkimit, planet e inspektimit dhe menaxhimit të kapaciteteve të peshkimit dhe të fermave, planet e menaxhimit të fermave të rritjes**

14. Deri më 15 shkurt të çdo viti, çdo CPC që ka kuotë të tonit të kuq do të paraqesë në Sekretariatit të ICCAT:

a) Një plan vjetor të peshkimit për anijet e peshkimit dhe kurthe të peshkimit të tonit të kuq në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe të hartuar në përputhje me paragrafët 16-17.

b) Një plan vjetor i menaxhimit të kapacitetit të peshkimit që siguron që kapaciteti i peshkimit i autorizuar i CPC është në përpjesëtim me kuotën e alokuar, të hartuar duke përfshirë informacionin e paraqitur në paragrafët 18-23.

c) Një plan monitorimi, kontrolli dhe inspektimi, me qëllim që të sigurojë përputhjen me dispozitat e këtij Rekomandimi.

d) Një plan vjetor të menaxhimit për fermat e rritjes, që është në përputhje me kërkesat e parashtruara në paragrafët 24-27, duke përfshirë të dhënat maksimale të autorizuara për fermë, kapacitetin maksimal për fermë dhe sasinë totale të peshkut për fermë të mbartur nga një vit më parë, në përputhje me paragrafin 8.

15. Për vitin 2019 dhe 2020, para 31 marsit të çdo viti dhe në përputhje me paragrafin 116 të këtij Rekomandimi, Komisioni do të thërrasë një mbledhje ndërseksionale të panelit 2 për të analizuar dhe miratuar planet e përmendura në paragrafin 14. Ky detyrim mund të rishikohet pas vitit 2020, për të lejuar miratimin e planeve për t'u bërë me anë të mjeteve elektronike. Në rast të mosdorëzimit të planeve nga një CPC ose nëse Komisioni gjen një gabim serioz në planet e paraqitura dhe nuk mund t'i miratojë këto plane, Komisioni vendos për pezullimin automatik të peshkimit të tonit të kuq në atë vit nga ai CPC. Mosdorëzimi i planit të përmendur më sipër automatikisht do të çojë në pezullimin e peshkimit të tonit të kuq në atë vit.

**Planet vjetore të peshkimit**

16. Çdo CPC do të hartojë një plan vjetor të peshkimit për anijet e peshkimit dhe kurthet që peshkojnë tonin e kuq në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe. Plani vjetor i peshkimit do të identifikojë, ndër të tjera, kuotat e ndara për secilin grup të formave të peshkimit, kur është e aplikueshme, metodën e përdorur për të alokuar dhe menaxhuar kuotat, si dhe masat që sigurojnë respektimin për kuotat individuale, hapjen e sezonit të peshkimit për secilën formë peshkimi si dhe rregullat e bashkëzënies (*by catch*).

17. Çdo modifikim i mëpasshëm i planit vjetor të peshkimit do t'i transmetohet Sekretariatit Ekzekutiv të ICCAT së paku një ditë pune para ushtrimit të veprimtarisë që korrespondon me atë ndryshim. Pavarësisht nga kjo dispozitë, transferimet e kuotave ndërmjet formave të ndryshme të peshkimit dhe transferimet në mes të kuotave të zënies dhe kuotave të bashkëzënies (*by catch*) nga i njëjti CPC do të lejohen, me kusht që informacioni mbi transferimet të transmetohet te Sekretariati i ICCAT, përpara hyrjes në fuqi.

### **Masat e menaxhimit të kapacitetit të peshkimit**

#### **Kapaciteti i peshkimit**

#### **Rregullimi i kapacitetit të peshkimit**

18. Çdo CPC do të përshtatë kapacitetin e tij të peshkimit për të siguruar se është në përpjesëtim me kuotën e ndarë për atë, duke përdorur normat përkatëse të zënies vjetore sipas segmentit të flotës dhe formës së peshkimit të propozuara nga SCRS dhe të miratuara nga Komisioni në 2009. Këto parametra duhet të rishikohen nga SCRS jo më vonë se 2019-a dhe çdo herë që një vlerësim i rezervës për tonin kryhet, do të përfshijë normat specifike të zënies për llojet e formave të peshkimit dhe zonat e peshkimit.

19. Për këtë qëllim, çdo CPC harton, kur është e përshtatshme, një plan vjetor për menaxhimin e kapacitetit të peshkimit për t'u analizuar dhe miratuar nga paneli 2 ndërsesional. Ky plan do të rregullojë numrin e anijeve të peshkimit për të demonstruar se kapaciteti i peshkimit është në përpjesëtim me mundësitë e peshkimit të ndara për anijet e peshkimit për të njëjtën periudhë të kuotës. Sa i përket anijeve të peshkimit të vogël bregdetar, kërkesa minimale e kuotës prej 5 t (norma e zënies e përcaktuar nga SCRS në vitin 2009) nuk do të jenë më të zbatueshme dhe kuotat e këtij sektori mund të aplikohen në mënyrë alternative tek ato anije si më poshtë:

a) Nëse një CPC ka anije të vogla peshkimi bregdetar të autorizuar për peshkimin e tonit të kuq, ai do të alokojë një kuotë specifike për këto anije dhe do ta pasqyrojë këtë në planet e tij të peshkimit dhe të inspektimit për zbatimin e cilave do të merren masa shtesë për të bërë të mundur monitorimin e drejtpërdrejtë të konsumimit (zënies) të kuotës nga ky segment i flotës.

b) Për anijet nga arkipelagët e Azorës, Ishujt Kanarie dhe Madeira, mund të krijohet një kuotë sektoriale për anijet me karrem. Kuota për këtë segment dhe kushtet shtesë për të monitoruar atë duhet të përcaktohen qartë në planin e peshkimit.

20. Rregullimi i kapacitetit të peshkimit për anijet me rrethim me koshilok do të kufizohet në një ndryshim maksimal prej 20% në krahasim me kapacitetin bazë të peshkimit të vitit 2018. CPC-të mund të rumbullakosin numrin e anijeve të peshkimit kur llogaritet kjo përqindje.

21. Për periudhën 2019-2020, CPC-të mund të autorizojnë një numër të kurtheve të tyre të angazhuara në peshkimin e tonit në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe, i cili lejon shfrytëzimin e plotë të mundësive të peshkimit.

22. Rregullimet e përcaktuara në paragrafët 20 dhe 21 nuk do të zbatohen:

a) nëse CPC-të e vendeve në zhvillim mund të tregojnë se ata kanë nevojë të zhvillojnë kapacitetin e tyre të peshkimit në mënyrë që të përdorin tërësisht kuotën e tyre, duke përdorur normat përkatëse të zënies vjetore sipas segmentit të flotës dhe formës së peshkimit të propozuar nga SCRS dhe nëse rregullimet e tilla përfshihen në planin vjetor të peshkimit në përputhje me paragrafin 14,

b) në Atlantikun Verilindor, ndaj atyre CPC që peshkojnë kryesisht në zonat e tyre ekonomike (zonën ekonomike norvegjeze dhe zonën ekonomike islandeze).

23. Duke iu shmangur dispozitave të paragrafëve 18, 19 dhe 21, për vitin 2019 dhe 2020, CPC-të mund të vendosin të përfshijnë në planet e tyre vjetore të peshkimit të përmendura në paragrafin 16 një numër të ndryshëm të kurtheve dhe anijeve për të shfrytëzuar plotësisht mundësitë e tyre të peshkimit. Llogaritjet për të vendosur rregullime të tilla duhet të bëhen në përputhje me metodologjinë e miratuar në mbledhjen vjetore të vitit 2009 dhe me kushtet e përcaktuara në paragrafin 19, me përjashtim të rasteve kur CPC-të që merren me peshkim kryesisht në Atlantikun Verilindor në zonat e tyre ekonomike (zonën ekonomike norvegjeze dhe zonën ekonomike islandeze).

### **Kapaciteti i kultivimit**

24. Çdo CPC që kultivon do të krijojë një plan vjetor të menaxhimit të kultivimit. Ky plan duhet të tregojë se kapaciteti i përgjithshëm i inputeve dhe kapaciteti i përgjithshëm kultivues është në përpjesëtim me shumën e vlerësuar të tonit të kuq të disponueshëm për kultivim, duke përfshirë informacionin e përmendur në paragrafët 25 dhe 27. Planet e rishikuara të menaxhimit të kultivimit, nëse është e përshtatshme, do të dorëzohen në Sekretariatit e ICCAT deri më 1 qershor të çdo viti. Komisioni do të sigurojë që kapaciteti total kultivues në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe është në përpjesëtim me sasinë totale të tonit të kuq të disponueshëm për kultivim në zonë.

25. Çdo CPC do të kufizojë kapacitetin e saj të kultivimit të tonit në kapacitetin total kultivues të fermave të cilat janë regjistruar në listën ICCAT ose janë autorizuar dhe deklaruar në ICCAT në vitin 2018.

26. Ato CPC të vendeve në zhvillim pa ferma kultivimi ose me më pak se tri ferma dhe që synojnë të krijojnë ferma të reja të kultivimit të tonit, kanë të drejtë të krijojnë ferma të tilla me një kapacitet maksimal kultivues deri në 1800 tonë për CPC. Për këtë qëllim, ata do t'i komunikojnë ICCAT duke i përfshirë ato në planin e tyre të kultivimit sipas paragrafit 14 të këtij Rekomandimi. Kjo pikë duhet të rishikohet më 2020-n.

27. Çdo CPC duhet të krijojë një maksimum hyrjesh vjetore për tonin e kuq të egër të kapur dhe futur në fermat e tij në nivel të të dhënave të regjistruara në ICCAT nga ferma e tij më 2005-n, 2006-n, 2007-n apo 2008-n. Nëse një CPC ka nevojë të rrisë kultivimin për tonin e peshkuar, kjo rritje duhet të jetë në përpjesëtim me kuotën e peshkimit të alokuar për atë CPC duke përfshirë edhe importet e tonit të kuq.

### **Normat e rritjes**

28. SCRS, në bazë të një protokollit të standardizuar që do të krijohet nga SCRS për monitorimin e peshqve individualisht të njohur (të markuar), do të ndërmerë mostra për të identifikuar normat e rritjes duke përfshirë peshën dhe madhësinë e rritjes gjatë periudhës së majmërisë. Bazuar në rezultatin e provave dhe informacioneve të tjera shkencore në dispozicion, SCRS do të shqyrtojë dhe përditësojë tabelën e rritjes të publikuar në vitin 2009 dhe normat e rritjes që përdoren për kultivimin e peshkut të referuar në paragrafin 35c dhe do të paraqesë këto rezultate në mbledhjen vjetore të Komisionit më 2020-n.

SCRS duhet të ftojë shkencëtarë të pavarur, të cilët kanë ekspertizën e duhur për të shqyrtuar analizën për përditësimin e tabelës së rritjes. SCRS do të marrë në konsideratë gjithashtu dallimin në mes të zonës gjeografike (duke përfshirë Atlantikun dhe Mesdheun) në përditësimin e tabelës. CPC-të që kanë ferma do të sigurojnë që shkencëtarët e ngarkuar nga SCRS për mostrat, mund të kenë qasje dhe, siç kërkohet nga protokollit, ndihmë për t'i kryer ato. CPC-të që kanë ferma do të përpiqen të sigurojnë që normat e rritjes që rrjedhin nga eBCD-të janë koherente me normat e rritjes të publikuara nga SCRS. Nëse vërehen mospërputhje të mëdha midis tabelave të SCRS dhe niveleve të rritjes të vërejtura, ky informacion duhet t'i dërgohet SCRS-së për analizë.

## **Pjesa III Masat teknike**

### **Sezonet e hapura të peshkimit**

29. Peshkimi me rrethim i tonit të kuq do të lejohet në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe gjatë periudhës nga 26 maj deri më 1 korrik.

Përrjashtim bëhet në Detin Mesdhe nga ana lindore (zonat e peshkimit të FAO-s 37.3.1 Egjeu; 37.3.2 Levant), sezoni hapet nga 15 maji nëse CPC e kërkojnë nën planin e tij të peshkimit.

Përrjashtimisht, në Detin Adriatik (zona e peshkimit FAO 37.2.1) sezoni mund të hapet nga 26 maji deri më 15 korrik, për peshqit e kultivuar në Detin Adriatik.

Përrjashtimisht, sezoni peshkimit me rrethim në zonën ekonomike norvegejeze dhe në zonën ekonomike islandeze do të jetë nga 15 qershori në 15 nëntor.

Përrjashtimisht, sezoni i peshkimit me rrethim në Atlantikun Lindor dhe zonat e peshkimit të Detit Mesdhe, të kufizuara me ujërat nën sovranitetin ose juridiksionin e Mbretërisë së Marokut mund të jenë të hapura nga 1 maji deri më 15 qershor nëse një CPC e kërkon atë në planin e tij të peshkimit.

30. Nëse kushtet e këqija të motit pengojnë operacionet e peshkimit, CPC mund të vendosin që sezonet e peshkimit të referuara në paragrafin 29 të shtyhen me një numër të barabartë të ditëve të peshkimit të humbura, por jo më shumë se 10 ditë.

31. Anijet, me linjë grepash pelagjikë, më të mëdha se 24 metra, do të lejohen të peshkojnë tonin e kuq në Atlantikun Lindor dhe në Mesdhe nga 1 janari deri më 31 maj me përjashtim të zonës së kufizuar në perëndim prej 10° dhe në veri të 42°, si dhe në zonën ekonomike norvegjeze, ku ky lloj peshkimi (me linjë grepash pelagjikë) do të lejohet gjatë periudhës 1 gusht deri më 31 janar.

32. CPC-të do të vendosin hapjen e sezonit të peshkimit për flotën e tyre, përveç peshkimit me rrethim dhe anijeve të referuara në paragrafin 31 dhe do ta përfshijnë këtë informacion në planin e tyre të peshkimit të përcaktuar në paragrafin 16 për t'u analizuar dhe për t'u miratuar nga paneli 2 ndërsezonal.

33. Jo më vonë se viti 2020, Komisioni do të vendosë se në çfarë mase sezonet e peshkimit për forma të ndryshme të peshkimit dhe/ose zonave të peshkimit mund të zgjerohen dhe/ose modifikohen në bazë të këshillave të SCRS pa ndikuar negativisht në zhvillimin e rezervës peshkore dhe duke siguruar që rezerva të menaxhohet në mënyrë të qëndrueshme.

#### **Madhësia minimale**

34. Madhësia minimale për tonin e zënë në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe do të jetë 30 kg ose me gjatësi 115 cm deri në degëzimin e bishtit. Prandaj, CPC-të do të marrin masat e nevojshme për ndalimin e peshkimit, mbajtjen në bord, transbordimin, transferimin, zbarkimin, transportimin, magazinimin, shitjen, reklamimin apo ofrimin për shitje të tonit të kuq që peshkon më pak se 30 kg ose me gjatësi më të vogël se 115 cm në bifurkacion.

35. Përjashtimisht nga paragrafit 34, për peshqit me peshë deri në 8 kg ose me gjatësi deri 75 cm aplikohen situatat e mëposhtme (**shiko shtojcën 1**):

a) toni i kuq i kapur në Atlantikun Lindor nga barkat me grepa lundruar dhe anijet tërheqëse;

b) toni i kuq i kapur në Detin Mesdhe nga peshkimi artizanal bregdetar për peshk të freskët me linja grepash, grepa lundruese dhe grepa dore;

c) toni i kuq kapur në Detin Adriatik për qëllime kultivimi.

Pavarësisht nga sa me sipër, për tonin e zënë në Detin Adriatik për qëllim kultivimi, CPC përkatëse mund të përcaktojnë një nivel tolerance për individë toni me një peshë minimale 6.4 kg ose 66 cm gjatësi, por jo më shumë se 7% të sasisë së zënë nga anijet kroate. Për më tepër, jo më shumë se 100 tonë mund të zihen nga anijet franceze me gjatësi më të vogël se 17 m, që peshkojnë në Gjirin e Biskajës, të tonit me peshë jo më pak se 6.4 kg ose 70 cm gjatësi në bifurkacion.

36. CPC-të në fjalë do të lëshojnë autorizime specifike për anijet që peshkojnë sipas përjashtimeve të përmendura në paragrafin 35. Përveç kësaj, peshqit poshtë këtyre madhësive minimale, hedhurinë e të ngordhur, do të llogariten brenda kuotës së CPC.

#### **Zëniet aksidentale të peshqve me përmasa nën minimumin e lejuar**

37. Për anijet dhe kurthet që peshkojnë në mënyrë aktive tonin e kuq, mund të autorizohen zënie aksidentale maksimumi deri 5% të individëve të tonit të kuq që peshojnë nga 8 deri 30 kg ose me gjatësi në bifurkacion nga 75 deri në 115 cm gjatësi.

Kjo përqindje llogaritet mbi zëniet totale aksidentale si numër individësh të tonit të kuq që ndodhen në bord të anijes, pas çdo operacioni peshkimi, në peshën dhe gjatësinë e përmendur më sipër.

#### **Rregullat e përgjithshme mbi bashkëzëniet (*by-catches*)**

38. Të gjitha CPC do të ndajnë një kuotë specifike për bashkëzëniet (*by-catch*) për tonin. Nivelet e bashkëzënieve të autorizuara si dhe metodologjia e llogaritjes së këtyre bashkëzënieve në raport me zënie totale (në peshë ose numër të individëve) do të përcaktohen qartë në planet vjetore të peshkimit, të dorëzuara në Sekretariatit e ICCAT sipas paragrafit 14 të këtij Rekomandimi dhe nuk duhet të kalojë 20% të totalit të sasisë në fund të çdo dalje për peshkimi. Llogaritja e numrit do të zbatohen vetëm për tonin dhe specie të ngjashme me tonin që menaxhohen nga ICCAT. Për anijet e peshkimit të vogël bregdetar sasia e bashkëzënieve duhet të llogaritet në bazë vjetore.

Të gjitha sasi të bashkëzënieve të tonit të kuq të ngordhur, të mbajtur në bord ose të hedhura si hedhurinë, do të zbriten nga kuota e CPC dhe duhet të raportohen në ICCAT. Nëse bashkëzënia e tonit të kuq është bërë në ujërat nën juridiksionin e peshkimit të CPC-ve, dhe në rast se legjislacioni vendas i këtyre CPC kërkon që të gjithë peshqit e ngordhur duhet të zbarkohen, ky detyrim për zbarkim duhet të përmbushet edhe nga anijet që lundrojnë me flamuj të huaj.

Nëse nuk ka kuota të alokuara nga CPC për anijet dhe kurthet e peshkimit, apo nëse është konsumuar kuota, nuk lejohet peshkimi i tonit si bashkëzënie dhe CPC duhet të marrin masat e duhura për të garantuar lëshimin e gjallë të tyre. Megjithatë, nëse toni i kuq është i ngordhur, duhet të zbarkohet dhe duhen ndjekur veprimet në përputhje me ligjin kombëtar. CPC-të do të informojnë mbi këto sasi në baza vjetore te



Sekretariati i ICCAT, i cili do ta vërë atë në dispozicion të SCRS.

Procedurat e referuara në paragrafët 77 deri 82 dhe 108 do të zbatohen për bashkëzënit.

Anijet që nuk peshkojnë në mënyrë aktive për tonin e kuq, çdo sasi të tij që mbajnë në bord duhet ta ndajnë qartësisht nga speciet e tjera, për të lejuar kështu që autoritet kontrolluese të monitorojnë respektimin e këtij rregulli.

#### **Peshkimi çlodhës/argëtues dhe peshkimi sportiv**

39. Kur CPC-të ndajnë, ku është e përshtatshme, një kuotë specifike për peshkimin sportiv dhe argëtues; kjo kuotë e caktuar duhet të vendoset në peshkimin sportiv dhe argëtues edhe nëse zënia dhe lëshimi i tonit është i detyrueshëm, për të llogaritur peshën e mundshme të peshqve të ngordhur. Çdo CPC duhet të rregullojë peshkimin çlodhës/argëtues duke lëshuar autorizime të peshkimit për këtë qëllim.

40. CPC-të duhet të marrin masat e duhura për të ndaluar zënieën dhe mbajtjen në bord, transbordimin ose zbarkimet e më shumë se një individi toni të kuq për çdo anije të peshkimit argëtues në ditë.

Ky ndalim nuk aplikohet tek ato CPC, legjislacioni i të cilëve kërkon që të zbarkohet i gjithë peshku i ngordhur, duke përfshirë edhe individët e zënë nga peshkimi sportiv dhe argëtues.

41. Tregtimi i tonit të kuq të zënë në peshkimin sportiv dhe argëtues është i ndaluar.

42. Çdo CPC duhet të marrë masa për të regjistruar të dhënat e zënieve duke përfshirë peshën e çdo toni të kuq të kapur gjatë peshkimit sportiv dhe argëtues dhe t'i komunikojë ato në Sekretariatit e ICCAT për vitin paraprak deri më 1 korrik të çdo viti.

43. Sasitë e tonit të ngordhur, të zëna nga peshkimin sportiv dhe argëtues do të llogariten kundrejt kuotës se alokuar për CPC në përputhje me paragrafin 5.

44. Çdo CPC do të marrë masat e nevojshme për të siguruar, në masën më të madhe të mundshme, lëshimin e tonit të kuq, sidomos të të vegjëlve, të kapur gjallë, në kuadrin e peshkimit argëtues dhe sportiv. Çdo ton i kuq i zbarkuar duhet të jetë i plotë, i pastruar dhe/ose i prerë.

45. Çdo CPC që dëshiron të kryejë një peshkim “kap dhe lësho” në Atlantikun Verilindor mund të lejojë një numër të kufizuar të anijeve sportive të synojnë tonin e kuq me qëllim të “marko/shënjo dhe liro” pa pasur nevojë të alokojë për to një kuotë specifike.

Kjo vlen për ato anije që veprojnë në kuadër të një projekti shkencor të një instituti kërkimi, të integruar në një program kërkimor shkencor, rezultatet e të cilit do t'i komunikohen SCRS. Në këtë kontekst, CPC-ja ka detyrimin: a) paraqesin përshkrimin dhe masat shoqëruese që zbatohen në këtë formë peshkimi si pjesë integrale e planeve të tyre të peshkimit dhe kontrollit siç referohet në paragrafin 14 të këtij Rekomandimi: b) të monitorojë nga afër aktivitetet e anijeve në fjalë për të siguruar përputhshmërinë e tyre me dispozitat ekzistuese të këtij Rekomandimi: c) të sigurojë që veprimtaria e markimit dhe lëshimit të tonit të kryhen nga personel i trajnuar për të siguruar mbijetesën e lartë të peshqve; dhe d) çdo vit të paraqesë një raport mbi aktivitetet shkencore të kryera, të paktën 60 ditë para mbledhjes SCRS të vitit vijues. Çdo ton i kuq që ngordh gjatë aktivitetit të markimit dhe lëshimit do të raportohet dhe do të zbritet nga kuota CPC-së.

46. CPC do të vënë në dispozicion, sipas kërkesës nga ICCAT, listën e anijeve të peshkimit sportiv dhe argëtues, të cilat kanë marrë një autorizim.

47. Formatit për një listë të tillë, referuar paragrafit 46, duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin e anijes, numrin e regjistrimit;
- b) numrin e ICCAT (nëse ka);
- c) emrin e mëparshëm (nëse ka);
- d) emrin dhe adresën e pronarit(ve) dhe operatorit(ëve).

### **Pjesa IV:**

#### **Masat e kontrollit**

##### **Seksioni A – Regjistri i anijeve dhe kurtheve**

#### **Përdorimi i mjeteve ajrore**

48. Përdorimi i çdo mjeti ajror, duke përfshirë aeroplanë, helikopterë ose çdo lloj të mjeteve ajrore pa ekuipazh për të kërkuar tonin e kuq, është i ndaluar.

#### **Regjistri i ICCAT për anijet e autorizuara për peshkimin e tonit të kuq**

49. CPC do të krijojnë dhe mbajnë një regjistër ICCAT për të gjitha anijet e peshkimit të autorizuara për të operuar për tonin e kuq në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe. Ky regjistër duhet të përmbajë dy lista:

a) të gjitha anijet aktive që janë të autorizuara për të peshkuar për tonin e kuq në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe.

b) të gjitha anijet e tjera të autorizuar, të përdorura për qëllime të shfrytëzimit komercial të rezervave të tonit të kuq përveç anijeve peshkuese, të cilat janë të autorizuar për të vepruar për tonin e kuq në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe.

Për anijet me një gjatësi >24 m (pavarësisht rrejtës së përdorur, duke përfshirë tratat fundore) dhe për anijet me rrethim me koshilok, CPC duhet të raportojnë numrin e tyre në Sekretariatit Ekzekutiv, si pjesë e planit të tyre të peshkimit të përcaktuar në paragrafin 14 të këtij rekomandimi dhe ICCAT do të krijojë dhe të mbajë një regjistër të ICCAT për të gjitha anijet e autorizuar që operojnë për tonin e kuq në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe.

50. Çdo CPC i dorëzon çdo vit në mënyrë elektronike Sekretarit Ekzekutiv të ICCAT, jo më vonë se 15 ditë para fillimit të veprimtarisë së peshkimit, listën e anijeve të peshkimit të autorizuar për të peshkuar në mënyrë aktive për tonin e kuq në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe referuar në paragrafin 49 (a). Dorëzimet duhet të bëhen në përputhje me formatin e përcaktuar në Udhëzimet për Dorëzimin e të Dhënave dhe Informatave të kërkuara nga ICCAT.

51. Nuk do të pranohen ndryshime të tjera, përveçse kur një anije peshkimi e përfshirë në listë, nuk mund të marrë pjesë për shkak të arsyeve operationale të legjitimuara ose *shkaqeve madhore*. Në këto rrethana, CPC në fjalë duhet të informojë menjëherë Sekretariatit Ekzekutiv të ICCAT, duke dhënë:

a) Detaje të plota të anijes/ve të peshkimit që mendohet të jetë zëvendësuese anijes/ve, të përfshira në të dhënat e përmendura në paragrafin 49; CPC me më pak se 5 anije në listë referuar në paragrafin 49, mund të zëvendësojë një anije me një tjetër anije që nuk është përfshirë më parë në të dhënat e përmendura në paragrafin 49 dhe për të cilën është dhënë një numër ICCAT nga Sekretariati.

b) Një përshkrim i kuptueshëm i arsyeve që justifikojnë zëvendësimin dhe çdo fakt apo referencë që mbështet atë.

Sekretariati i ICCAT do t'i shpërndajë këto raste midis CPC-ve. Nëse ndonjë CPC njofton se rasti nuk është analizuar mjaftueshëm ose është jo i plotë, ai do të dërgohet në Komitetin e Përputhshmërisë për shqyrtim të mëtejshëm dhe do të mbetet në pritje të miratimit të Komitetit të Përputhshmërisë.

52. Kushtet dhe procedurat e përmendura në Rekomandimin e ICCAT në lidhje me formimin e një regjistri anijesh me gjatësi të përgjithshme ose më të mëdha se 20 metra dhe të autorizuar për të vepruar në zonën e Konventës [Rec. 13-13] (me përjashtim të paragrafit 3) do të aplikohen pjesë-pjesë (*mutatis mutandis*).

53. Pa paragjykuar paragrafin 38 për qëllimet e këtij Rekomandimi, anijet e peshkimit që nuk hyjnë në një nga regjistrat e ICCAT të parashikuara në pikat a) dhe b) në paragrafin 49, sugjerohet të mos autorizohen për të peshkuar, mbajtur në bord, transborduar, transferuar, përpunuar apo zarkuar tonin e kuq në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe. Ndalimi për mbajtjen në bord nuk aplikohet për CPC, të cilave legjislacioni i brendshëm u kërkon zarkimin e të gjithë peshqve të ngordhur, duke siguruar që vlera e tyre është subjekt konfiskimi.

#### **Autorizimet e peshkimit për anijet dhe kurthet e autorizuar për peshkimin e tonit të kuq**

54. CPC lëshon autorizime të veçanta dhe/ose licence kombëtare peshkimi për barkat dhe kurthet të përfshira në një prej listave të përshkruara në paragrafët 45, 49 dhe 56. Autorizimet për peshkim do të përmbajnë si informacion minimal atë të paraqitur në **shtojcën 12**. CPC duhet të sigurojnë se informacioni që përmban autorizimi për peshkim të jenë të saktë dhe në përputhje me rregullat e ICCAT. CPC do të marrë masat e nevojshme të forcimit të zbatimit të legjislacionit të tyre dhe mund të kërkojë që anija të kthehet menjëherë në një port të caktuar kur kuota individuale është peshkuar.

#### **Regjistri i ICCAT për kurthet e autorizuar për të peshkuar tonin e kuq**

55. Komisioni krijon dhe mban një regjistër të ICCAT për të gjitha kurthet e tonit të autorizuar për peshkimin e tonit të kuq në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe. Me qëllim zbatimin e kësaj rregulloreje, kurthet e tonit që nuk janë regjistruar, sugjerohet të mos autorizohen për të peshkuar apo mbajtur ton dhe të mos marrin pjesë në aktivitetin e peshkimit, transferimit, zënies apo zarkimit të tonin e kuq.

56. Çdo CPC do të dërgojë në format elektronik në Sekretariatit Ekzekutiv të ICCAT, si pjesë e planit të tij të peshkimit, të përcaktuar në paragrafët 16 deri 17, listën (duke përfshirë emrin e kurthit, numrin e regjistrit) e kurtheve të autorizuar të tonit sipas paragrafit 55.

Kushtet dhe procedurat e parashikuara në Rekomandimin 13-13 (me përjashtim të paragrafit 3) do të aplikohen pjesë-pjesë (*mutatis mutandis*).

#### **Informacion mbi aktivitetin e peshkimit**

57. Më 31 korrik të çdo viti ose brenda 7 muajve të përfundimit të sezonit të peshkimit për ato CPC që përfundojnë fushatën e tyre të peshkimit në korrik, çdo CPC dërgon një informacion të detajuar mbi zëniet e tonit të kuq në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe, e cila paraprin periudhën e alokimit të kuotave. Ky

informacion duhet të përfshijë:

- a) emrin dhe numrin ICCAT të secilës anije peshkimi;
- b) periudhën e autorizimit për çdo anije peshkimi;
- c) kapjet totale të secilës anije peshkuese, duke përfshirë kthimet zero (pa zënie) gjatë gjithë periudhës së autorizimit;
- d) numri i përgjithshëm i ditëve të çdo anije peshkimi që ka peshkuar në Atlantikun Lindor dhe Mesdhe gjatë gjithë periudhës së autorizimit; dhe
- e) kapjet totale jashtë periudhës së autorizimit të tyre (bashkëzënie).

Për të gjitha anijet të cilat nuk janë të autorizuar për të peshkuar në mënyrë aktive për ton të kuq në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe, por që kanë zënë ton të kuq si bashkëzënie:

- a) emrin dhe numrin ICCAT apo numrin kombëtar të regjistrimit të anijes, nëse nuk është e regjistruar me ICCAT;
- b) zëniet totale të tonit të kuq.

58. Çdo CPC njofton Sekretariatit e ICCAT për çdo informacion që ka lidhje me anijet peshkuese që nuk përfshihen në paragrafin 57, por të njohura apo të supozuara që kanë peshkuar për tonin e kuq në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe. Sekretariati i ICCAT e përcjellë këtë informacion të CPC, për veprim sipas rastit, si dhe një kopje për informacion të CPC tjera.

#### **Operacionet e përbashkëta të peshkimit**

59. Çdo operacion i përbashkët i peshkimit për tonin e kuq autorizohet vetëm me pëlqimin e CPC-ve në fjalë. Do të autorizohet çdo anije për peshkim me rrethim, e pajisur për të peshkuar tonin e kuq, që ka një kuotë individuale të shpërndarë, dhe për të vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në 65, 66 dhe 67. Kuota e alokuar për një operacion të përbashkët peshkimi (JFO), do të jetë e barabartë me totalin e të gjitha kuotave të ndara për çdo anije me rrethim që marrin pjesë në këtë JFO. Për më tepër, kohëzgjatja e JFO nuk do të jetë më e gjatë se kohëzgjatja e sezonit të peshkimit për anijet me rrethim, siç referohet në paragrafin 29 të këtij Rekomandimi.

60. Në momentin e aplikimit për autorizim, duke ndjekur formatin e aneksit 5, çdo CPC duhet marrë masat e nevojshme për të marrë nga anijet e tij me rrethim që marrin pjesë në një operacion të përbashkët peshkimi, informacionin e mëposhtëm:

- periudhën e autorizimit të JFO,
- identitetin e operatorëve të përfshirë,
- kuotat individuale të anijeve,
- çelësin ndarës të kuotave ndërmjet anijeve të përfshira në zënie, dhe
- informacionin mbi feramat e destinuar ku shkon peshku.

Çdo CPC transmeton gjithë informacionin e përmendur më lart në Sekretariatit e ICCAT të paktën pesë ditë para fillimit të sezonit të peshkimit me rrethim, siç përcaktohet në paragrafin 29.

Në rastet e ndonjë force madhore, afatet e përcaktuara në këtë paragraf nuk zbatohen në lidhje me informacionin mbi feramat ku shkon peshku. Në raste të tilla, CPC i sigurojnë Sekretariatit të ICCAT një përditësim të këtij informacioni sa më shpejt që të jetë e mundur, së bashku me një përshkrim të ngjarjeve që përbëjnë këtë forcë madhore. Sekretariati përpilon informacionin e përmendur në këtë paragraf, të siguar nga CPC, për shqyrtim nga Komiteti i Përputhshmërisë.

61. Komisioni krijon dhe mban një regjister të ICCAT për të gjitha operacionet e përbashkëta të peshkimit të autorizuar nga CPC-të në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe.

62. Nuk do të lejohen JFO mes anijeve të peshkimit me rrethim të CPC të ndryshme. Megjithatë, një CPC me më pak se pesë anije të autorizuar të peshkimit me rrethim mund të autorizojë operacionet e përbashkëta të peshkimit me çdo CPC tjetër. Çdo CPC që kryen një JFO do të jetë përgjegjës dhe i përgjegjshëm për të zëniet e bëra sipas këtij JFO.

### **Pjesa IV**

#### **Masat e kontrollit**

#### **Seksioni B – Zëniet dhe Transbordimet**

##### **Kërkesat e regjistrimit**

63. Kapitenët e anijeve të peshkimit duhet të mbajnë një libër zënieje në formë ditari (*logbook*) ose *logbook* elektronik për operacionet e tyre të peshkimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në seksionin A, të shtojcës 2.

64. Kapitenët e anijeve rimorkuese, anijet ndihmëse dhe anijet përpunuese do të regjistrojnë aktivitetet e

tyre në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenet B, C dhe D të shtojcës 2.

### **Raportet e zënieve të dërguara nga kapitenët e anijeve dhe operatorët e kurtheve**

65. Çdo CPC do të sigurojë që anijet e tij, që peshkojnë në mënyrë aktive për ton, gjatë gjithë periudhës për të cilën ato janë autorizuar të peshkojnë tonin, do të komunikojnë në formë elektronike ose çdo mënyrë tjetër efektive informacione ditore nga *logbook*-et, duke përfshirë datën, kohën, vendin (gjerësi dhe gjatësi gjeografike), peshën dhe numrin e tonit të kuq të zënë në zonën e mbuluar nga ky plan, përfshirë edhe lëshimet dhe hedhurinat e peshkut të ngordhur nën minimumin e madhësisë së lejuar, referuar në paragrafin 34. Kapitenët do të dërgojnë këtë informacion me formatin e përcaktuar në aneksin 2, ose përmes kërkesave raportuese të CPC-ve.

66. Kapitenët anijeve të peshkimit me rrethim duhet të përgatisin raporte sipas paragrafit 65 mbi operacionet e peshkimit, duke përfshirë edhe operacionet ku zëniet janë zero. Raportet do të transmetohen nga operatori te autoriteti CPC i vendit të tij, deri në orën 9:00 (GMT) të ditës tjetër.

67. Zotëruesit e kurtheve ose autoritetet e tyre përgjegjëse për peshkimin e tonit të kuq duhet të dërgojnë raport ditor mbi zëniet ditore në format elektronik, në të cilin do të përfshijnë numrin e regjistrit ICCAT, datën, kohën, zëniet (pesha dhe numri i peshkut), duke përfshirë edhe ato ku peshkimin zero. Ata do të dërgojnë këtë informacion CPC-së tyre, brenda 48 orësh në formë elektronike sipas formatit të përcaktuar në aneksin 2 për gjatë gjithë periudhës që ato janë të autorizuar për të peshkuar tonin e kuq.

68. Përveç anijeve të peshkimit me rrethim dhe me kurthe të zënies së tonit, kapitenët e anijeve të tjera, transmetojnë pranë autoriteteve të tyre të kontrollit, raportet e përmendura në paragrafin 65, deri mesditën e fundit të së martës pasardhëse, për javën e mëparshme që ka përfunduar të dielën.

### **Portet e caktuara**

69. Çdo CPC, të cilit i është alokuar një kuotë e tonit të kuq, do të përcaktojë portet në të cilat operacioni zbarkimit apo transbordimi të tonit të kuq është i autorizuar. Kjo listë do të komunikohet çdo vit në Sekretariatit e ICCAT si pjesë e planit vjetor të peshkimit të komunikuar nga çdo CPC. Çdo ndryshim do t'i komunikohet Sekretariatit të ICCAT. CPC e tjera mund të caktojnë portet në të cilat autorizohet zbarkimi ose transbordimi i tonit të kuq dhe të komunikojnë këtë listë të këtyre porteve te Sekretariati i ICCAT.

70. Për një port që të përcaktohet si port i caktuar, shteti portual do të sigurojë që kërkesat e mëposhtme plotësohen:

- a) përcaktimin e kohës së zbarkimit dhe transbordimit;
- b) përcaktimin e vendit të zbarkimit dhe transbordimit;
- c) vendosjen e procedurave të inspektimit dhe të mbikëqyrjes që sigurojnë mbikëqyrje e inspektim gjatë të gjitha kohës dhe në të gjitha vendet e zbarkimit dhe transbordimit në përputhje me paragrafin 73.

71. Ndalohet të zbarkohet ose transbordohet nga anijet e peshkimit, si dhe nga anijet përpunuese dhe anijet ndihmëse, çdo sasi toni të kuq të peshkuara në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe, në çdo vend tjetër përveçse porteve të përcaktuara nga CPC në përputhje me paragrafët 69 deri 70. Megjithatë, përjashtimisht, transportimi i tonit të ngordhur të zënë në kurth/kosh, duke përdorur një anije ndihmëse për në anijet e përpunimit, nuk është i ndaluar.

72. Në bazë të informacionit të marrë nga CPC sipas paragrafit 69, Sekretariati i ICCAT do të mbajë një listë të porteve të përcaktuara në website ICCAT.

### **Njoftimi paraprak i zbarkimeve**

73. Para hyrjes në ndonjë port, kapitenët e anijeve të peshkimit, si dhe të anijeve e përpunuese dhe anijeve ndihmëse ose përfaqësuesit e tyre, duhet të sigurojnë autoritetit përkatës të portit, të paktën 4 orë përpara kohës së parashikuar të mbërritjes, me sa vijon:

- a) kohën e parashikuar për mbërritje;
- b) sasinë e vlerësuar të tonit të kuq të mbajtur në bord;
- c) informacionin mbi zonën gjeografike ku është zënë toni i kuq.

Nëse zonat e peshkimit janë më pak se katër orë nga porti ku mbërrihet, sasinë e vlerësuar të tonit të kuq të mbajtura në bord mund të modifikohen në çdo kohë përpara aritjes në port.

CPC-të mund të vendosin të zbatojnë këto dispozita vetëm për zënie të barabarta ose më të mëdha se tre peshk ose një ton. Ata duhet të japin këtë informacion në planin e kontrollit të tyre të monitorimit dhe inspektimit të përmendur në paragrafin 14.

Autoriteti shtetit portual mban një regjistër me të gjitha njoftimet paraprake për vitin në vazhdim.

Të gjitha veprimet e zbarkimit dhe zënieve duhet të kontrollohen nga autoritetet përkatës të kontrollit dhe një përqindje e tyre duhet të inspektohet, bazuar në sistemin e vlerësimit të riskut, duke përfshirë kuotën, përmasat e flotës dhe sforcën e peshkimit. Detaje të plota të këtij sistemi kontrollesh të përshtatura

nga çdo CPC, duke përfshirë përqindjen e synuar të zbarkimeve që do të inspektohen, duhet të jenë të detajuara në planin e tyre vjetor të inspektimit referuar paragrafit 14 të këtij rekomandimi.

Pas çdo udhëtimi, kapitenët e anijeve të peshkimit, duhet të dorëzojnë brenda 48 orëve një deklaratë zbarkimi tek autoritetet kompetente të CPC-së ku bëhet ky zbarkim, si dhe shtetit të tij flamur. Kapiteni i anijes së peshkimit të autorizuar është përgjegjës për plotësimin dhe vërtetësinë e deklaratës, e cila duhet të tregojë së paku sasinë e tonit të kuq të zbarkuar dhe zonën ku është zënë. Të gjitha zëniet e zbarkuara duhet të peshohen dhe jo vetëm të vlerësohen. Autoriteteve përkatëse do të dërgojnë një regjistër mbi zëniet në autoritetin përkatës të CPC-ve të anijes së peshkimit, brenda 48 orëve nga përfundimi i zbarkimit.

#### **Raportimi i zënieve nga CPC te Sekretariati i ICCAT**

74. Çdo CPC do të dërgojë çdo javë te Sekretariati ICCAT raportet e zënieve nga anijet e peshkimit me rrethim dhe kurtheve të përcaktuara në paragrafët 66 dhe 67, si dhe raportet javore të anijeve që përdorin çdo rrjetë tjetër. Në bazë të këtij informacioni, Sekretariati i ICCAT, brenda 10 ditëve nga afatet mujore për marrjen e statistikave të përkohshme të zënies, mbledh informacionin e marrë dhe e shpërndan në CPC.

75. CPC-të do t'i raportojë Sekretariatit të ICCAT datën kur e gjithë kuota e tonit të kuq është shfrytëzuar. Sekretariati i ICCAT-it duhet ta shpërndajë këtë informacion te të gjitha CPC-të.

#### **Verifikimi**

76. CPC duhet të verifikojnë, si raportet e inspektimit dhe raportet e vëzhguesit, të dhënat VMS-ve, ku është e mundur të dhënat e-BCD, si dhe dorëzimin në kohë të *logbook*-eve dhe informacionin e kërkuar të shënuar në *logbook*-et e anijeve të peshkimit, në dokumentet e transferimit/transbordimit dhe në dokumentet e zënieve.

Autoritetet kompetente duhet të kryejnë kontrollet e të gjitha zënieve, e të gjitha transferimeve, ose zëniet midis sasive të specieve të regjistruara në librat e mjeteve të peshkimit ose sasitë e specieve të regjistruara në deklaratat e transbordimit dhe sasitë e regjistruara në deklaratat e zënieve ose deklaratat e kapjeve, dhe në çdo dokument tjetër përkatës, të tilla si fatura dhe/ose shënimet e shitjeve.

Autoritetet kompetente do të kryejnë kontrole verifikimi në të gjitha zbarkimet, të gjitha transbordimet, transferimet ose futjen në kosha ndërmjet sasive sipas specieve të regjistruara në *logbook*-un e anijes së peshkimit ose sasitë sipas specieve të regjistruara në deklaratën e transbordimit dhe sasitë e regjistruara në deklaratën e zbarkimit ose në deklaratën e futjes në kosha, dhe çdo dokument tjetër përkatës, siç janë faturat dhe/ose shënimet e shitjes.

#### **Transbordimi**

77. Operacionet e transbordimit të tonit të kuq në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe do të lejohen vetëm në portet e caktuara sipas përcaktimeve dhe kushtëzimeve në paragrafët 69 deri 72.

78. Para hyrjes në ndonjë port, anija e peshkimit transferuese, ose përfaqësuesi i saj, duhet t'i japë autoritetit përkatës të shtetit portual të paktën 72 orë përpara kohës së parashikuar të mbërritjes, informacionin e shënuar në aneksin 3, sipas ligjit kombëtar të shtetit portual. Çdo transbordim kërkon autorizimin paraprak nga CPC e anijes së peshkimit transborduese. Për më tepër, kapiteni i anijes së peshkimit transborduese, në kohën e transbordimit, informon CPC-në e tij sipas të dhënave të kërkuara në shtojcën 3.

79. Autoriteti përkatës i shtetit portual duhet të inspektojë anijen transborduese në mbërritje dhe do të kontrollojë ngarkesën dhe dokumentacionin që lidhet me operacionin e transbordimit.

80. Kapitenët e anijeve të peshkimit plotësojnë dhe transmetojnë te CPC e tyre deklaratën e transbordimit jo më vonë se 15 ditë pas datës së transbordimit në port sipas Rekomandimit 16-15. Kapitenët e anijeve të peshkimit transborduese plotësojnë deklaratën e transbordimit të ICCAT në përputhje me formatin e përcaktuar në shtojcën 3. Deklarata transbordimit duhet të jetë e lidhur me e-BCD për të lehtësuar verifikimin e të dhënave të përmbajtura në to.

81. Organi kompetent i shtetit portual do të dërgojë të dhëna të transbordimit autoritetit të CPC të anijeve të peshkimit transborduese, brenda 5 ditëve pasi transbordimi ka përfunduar.

82. Të gjitha transbordimet do të inspektohen nga autoritetet përkatëse të portit caktuar nga CPC.

### **Pjesa IV**

#### **Masat kontrolluese**

#### **Seksioni C – Programet e Vëzhgimit**

##### **Programi vëzhguesit (mbikëqyrësit) i CPC**

83. Çdo CPC siguron mbulimin nga vëzhguesit, për të cilët lëshohet një dokument zyrtar identifikimi, për anijet dhe kurthet aktive në peshkimin e tonit të kuq për të paktën:

- 20% të anijeve aktive me peshkim fundor pellajik (mbi 15 m),

- 20% të anijeve aktive me linjë grepash (mbi 15 m),
- 20% të anijeve aktive me grepa lundruës (mbi 15 m),
- 100% të anijeve rimorkiator;
- 100% të operacioneve të kapjes me kurthe.

CPC me më pak se pesë anije sipas tre segmenteve të para të mësipërme, të autorizuar për të peshkuar në mënyrë aktive tonin e kuq, duhet të sigurojnë mbulimin me vëzhgues në 20% të kohës që këto anije janë aktive në peshkimin e tonit të kuq.

Detyra e vëzhguesit duhet të jetë, në veçanti:

- a) të monitorojë anijet e peshkimit dhe kurthet në përputhje me këtë rekomandim;
- b) të regjistrojë dhe raportojë mbi aktivitetin e peshkimit, duke përfshirë ndërmjet të tjerave si më poshtë:
  - sasinë e zënieve (duke përfshirë zëniet jo objekt peshkimi) duke përfshirë dhe listën e llojeve, si ato të mbajtura në bord ose të hedhura në det të gjallë ose të ngordhur;
  - zonën e zënies sipas gjatësisë dhe gjerësisë gjeografike;
  - masën e sforcos (p.sh., numri i rrethimeve, numri i grepave etj.), siç përcaktohet në manualin e ICCAT për vegla të ndryshme të peshkimit;
  - datën e zënieve.
- c) të vëzhgojë dhe të vlerësojë zëniet dhe verifikojnë shënimet e bëra në *logbook*;
- d) të mbikëqyrë dhe të regjistrojë anijet që mund të jenë duke peshkuar në kundërshtim me masat konservuese të ICCAT.

Për më tepër, vëzhguesit mund të kryejë dhe punë shkencore, si p.sh., mbledhjen e të dhënave të kërkuara nga Komisioni, bazuar në instruksionet e SCRS.

Në zbatimin të kërkesave për vëzhguesit, CPC duhet:

- a) të sigurojë mbulimin përfaqësues në kohë dhe në hapësirë për të siguruar që Komisioni të marrë të dhëna të përshtatshme dhe të mjaftueshme dhe informacion mbi zëniet, sforcon dhe aspektet e tjera të menaxhimit dhe ato shkencore, duke pasur parasysh karakteristikat e flotës dhe peshkimit;
- b) të sigurojë protokolle të sigurta të mbledhjes së të dhënave;
- c) të sigurojë nëse vëzhguesit janë të trajnuar dhe aprovuar para vendosjes së tyre;
- d) të sigurojë, për sa është e mundur, pengimin sa më të vogël të aktivitetit të anijeve dhe kurtheve që peshkojnë në zonën e Konventës ICCAT.

Të dhënat dhe informacioni i mbledhur në secilin prej programeve të vëzhgimit nga CPC-të do t'i dërgohen SCRS dhe Komisionit, në përputhje me kërkesat dhe procedurat që do të hartohen nga Komisioni gjatë vitit 2019 duke marrë parasysh kërkesat e konfidencialitetit nga ana e CPC-ve.

Për aspektin shkencor të këtij programi, SCRS do të raportojë për nivelin e mbulimit të arritur nga çdo CPC, dhe do të sigurojë një përmbledhje të të dhënave të mbledhura dhe çdo rezultat të rëndësishëm të lidhur me këto të dhëna. SCRS do të japë çdo rekomandim që lidhet me përmirësimin e efikasitetit të programit të vëzhgimit të CPC.

### **Programi Rajonal i Vëzhguesve të ICCAT**

84. Programi Rajonal i Vëzhguesve të ICCAT do të zbatohet për të siguruar mbulimin 100% me vëzhgues:

- të të gjithë anijeve me rrethim të tonit të kuq;
- gjatë të gjitha transferimeve të tonit të kuq nga anijet e peshkimit me rrethim;
- gjatë të gjitha transferimeve të tonit të kuq nga kurthet në koshat transportues;
- gjatë të gjitha transferimeve nga njëra fermë në tjetrën;
- gjatë të gjitha transferimeve në kosha të tonit të kuq në ferma;
- gjatë të gjitha kapjeve në ferma;
- gjatë gjithë lëshimeve të tonit të kuq nga koshat e rritjes në det.

Anijet e peshkimit me rrethim pa një vëzhgues rajonal të ICCAT në bord, nuk do të autorizohen për të peshkuar ose të operojnë në peshkimin e tonit të kuq.

Vëzhguesit rajonalë të ICCAT nuk duhet të jenë me nacionalitet të njëjtë me atë të shtetit që është anija peshkuese/anije rimorkiator/kurth ose fermë, ku kërkohen shërbimet e tyre, por për aq sa është e mundur, Sekretariati i ICCAT duhet të sigurojë që vëzhguesit rajonalë të kenë njohuri të mjaftueshme të gjuhës të anijeve apo kurtheve të CPC së caktuar.

85. Detyrat rajonale të vëzhguesve të ICCAT-së në veçanti do të jenë:

- të vëzhgojnë dhe të monitorojnë operacionet e peshkimit dhe të kultivimit në përputhje me masat përkatëse të ruajtjes dhe menaxhimit të ICCAT, duke përfshirë aksesin në pamjet e kamerave stereoskopike

në kohën e vendosjes në kosha që mundëson matjen e gjatësisë dhe vlerësimin e peshës përkatëse;

- të nënshkruajnë deklaratat e transferimit të ICCAT dhe BCDs kur ai/ajo është dakord me informacionin si dhe ky informacion është në përputhje me vëzhgimet e tij/saj. Nëse ai/ajo nuk është dakord, ai/ajo duhet të tregojë atë në deklaratat e tij/saj në deklaratat e transferimit dhe BCDs dhe të shkruajë arsyet e mosmarrëveshjes duke cituar në mënyrë specifike rregullin(at) ose procedurën(at) e cila nuk është respektuar;

- të kryejë një punë të tillë shkencore, për shembull mbledhjen e mostrave, siç kërkohet nga Komisioni bazuar në direktivat nga SCRS.

## **Pjesa IV**

### **Masat e kontrollit**

#### **Seksioni D - Peshku i gjallë**

#### **Transferimet**

##### **Autorizimi i transferimit**

86. Përpara çdo operacioni transferimi, kapiteni i anijes së peshkimit ose rimorkiatorit apo përfaqësuesit e tyre ose përfaqësuesit e fermës apo kurthit, ku transferimi në fjalë buron, duhet të dërgojnë tek autoritetet përkatëse të peshkimit dhe të kultivimit të CPC, një njoftim paraprak transferimi duke përcaktuar:

- emrin e anijes ose fermës/kurthit dhe numrin e regjistrimit të ICCAT,

- kohën e parashikuar të transferimit,

- sasinë e parashikuar të tonit të kuq që do të transferohet,

- informacionin mbi pozicionin (gjerësi / gjatësi gjeografike) ku do të kryhet transferimi dhe numrat identifikues të koshave;

- emrin e anijes rimorkiatore, numrin e koshave që tërheq dhe numrin e regjistrimit të ICCAT.

- portin, fermën, koshin e destinacionit për tonin.

Për këtë qëllim, CPC do të caktojë një numër unik për çdo kosh transporti. Nëse disa kosha të transportit duhet të përdoren kur transferojnë një zënie që i korrespondon një operacioni të peshkimit, kërkohet vetëm një deklaratë transferimi, por numri i secilit kafaz transporti të përdorur duhet të regjistrohet në deklaratën e transferimit, duke treguar qartë sasinë e tonit të kuq të transportuar në secilin kosh.

Numri i koshit duhet të nxirret me një sistem numerik unik që përfshin të paktën 3 shkronja të kodit të CPC të ndjekur nga tre numra.

Numrat unikë të koshit duhet të jenë të përhershme dhe jo të transferueshme (d.m.th., Numrat nuk mund të ndryshohen nga një kosh në tjetrin).

87. CPC-ja cakton dhe i komunikon kapitenit të anijes së peshkimit, kurthit apo fermës një numër autorizimi për çdo operacion transferimi. Operacioni i transferimit nuk do të fillojë pa autorizimin paraprak të lëshuar në përputhje me një sistem numerik unik që përfshin kodin me 3 shkronja të CPC, 4 numra që tregojnë vitin dhe 3 shkronja që tregojnë autorizimin pozitiv (AUT) ose autorizimin negativ (NEG), pasuar nga numrat pasardhës nga autoritetet e CPC të anijes peshkuese, anijes rimorkiatore, fermës ose kurthit. Informacioni në lidhje me peshqit e ngordhur do të regjistrohet në përputhje me procedurat e paraqitura në shtojcën 11.

Transferimi duhet të autorizohet ose të mos-autorizohet nga CPC e anijes, fermës ose kurthit të peshkimit, sipas rastit, brenda 48 orëve pas dorëzimit të njoftimit paraprak të transferimit.

##### **Refuzimi i autorizimit të transferimit dhe lëshimi i tonit të kuq**

88. Nëse CPC e anijes peshkimit, anijes rimorkiuese ose autoritetet e CPC-së, ku ndodhet ferma ose kurthi, konsideron me marrjen e njoftimit paraprak të transferimit, që:

a) anija peshkimit ose kurthi ka deklaruar zënien e peshkut ton pa pasur kuota të mjaftueshme;

b) sasia e peshkut nuk është raportuar siç duhet nga anija ose kurthi i peshkimit ose nuk është autorizuar të futet në kosha dhe për këtë arsye nuk merret parasysh për konsumimin e kuotës që mund të jetë e zbatueshme;

c) anija peshkimit që ka deklaruar zënie peshku nuk ka një autorizim të vlefshëm për zënien e tonit të kuq të lëshuar në përputhje me paragrafin 54 të këtij rekomandimi, ose

d) anija rimorkiatore që deklaron se ka marrë pjesë në transferimin e peshkut nuk është regjistruar në regjistrin ICCAT të të gjitha anijeve të tjera të peshkimit të referuar në paragrafin 49.b) ose nuk është e pajisur me një Sistem Monitorimi *Vessel* (VMS) plotësisht funksional dhe/ose ndonjë pajisja tjetër gjurmuese, ekuivalente të VMS-së, transferimi nuk do të autorizohet.

Në rast se transferimi nuk është i autorizuar, CPC-ja që e ka zënë do të lëshojë menjëherë një urdhër lëshimi për anijen e peshkimit, kurthin ose fermën sipas rastit për t'i informuar ata se transferimi nuk është i autorizuar dhe duhet të vazhdojnë me lëshimin e peshkut në det në përputhje me shtojcën 10 të këtij Rekomandimi.

Në rast të defektit teknik të VMS-së gjatë transportit në fermë, anija rimorkiuese duhet të zëvendësohet me një anije tjetër rimorkiatorë, e cila ka një sistem VMS plotësisht funksional ose të instalohet një sistem i ri operativ i VMS-së në anije, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 72 orë, me përjashtim të rasteve të forcës madhore ose kufizimeve legjitime operationale, dhe që duhet t'i komunikohen Sekretariatit. Ndërkohë, kapiteni ose përfaqësuesi i tij, duke filluar që nga koha kur ngjarja u zbulua dhe/ose u informua, i komunikon autoriteteve të kontrollit të CPC përkatëse çdo 4 orë koordinatat gjeografike ku ndodhet anija e peshkimit me anë të mjeteve të ndërlidhjes.

#### **Deklarimi i transferimit**

89. Kapitenët e anijeve të peshkimit ose rimorkiatorëve, apo përfaqësuesit e fermës ose kurthit duhet të plotësojnë dhe të transmetojnë në CPC e tyre, deklaratën e transferimit të ICCAT në fund të operacionit të transferimit në përputhje me formatin e paraqitur në shtojcën 4.

- Deklaratës së transferimit do t'i jepet numër nga autoritetet CPC të anijes, fermës apo kurthit ku janë bërë transferimet. Sistemi i numërimit përfshin 3 shkronja të kodit të CPC, të ndjekura nga 4 numra që tregojnë vitin dhe 3 shkronja që përcaktojnë autorizimin, të ndjekura nga 3 shkronja ITD (CPC-20\*\*/xxx/ITD)

- Deklarata origjinale e transferues do të shoqërojë transferimin e peshkut. Një kopje e deklaratës duhet të mbahet nga anija e peshkimit ose kurthi dhe anija rimorkiutore.

- Kapitenët e anijeve që kryejnë operacionet transferuese do të raportojnë aktivitetin e tyre në përputhje me kërkesat e vendosura në shtojcën 2.

90. Autorizimi për transferim nga CPC-ja e flamurit nuk paragjykon konfirmimin e operacionit të vendosjes së peshkut në kosha.

#### **Monitorimi me video-kamera i një transferimi**

91. Për transferimet e tonit të kuq, kapiteni i anijes së peshkimit ose përfaqësuesit e kurthit apo fermës, kur është e përshtatshme, duhet të sigurojnë që aktivitetet e transferimit të monitorohen nga video-kamera nënujore, me qëllim të verifikimit të numrit të peshqve që transferohen. Standardet minimale dhe procedurat për kasetat e regjistrimit do të jenë në përputhje me shtojcën 8.

CPC do të vënë në dispozicion të SCRS kopjet e kasetave të regjistrimit kur kërkohet. SCRS duhet të ruajnë konfidencialitetin e aktiviteteve tregtare.

#### **Verifikimi nga vëzhguesit rajonalë të ICCAT-it dhe nisja dhe kryerja e hetimeve**

##### **Vëzhguesi rajonal i ICCAT në bordin e anijes së peshkimit dhe të fermave**

92. Vëzhguesi rajonal i ICCAT në bordin e anijes peshkimit dhe kurthit, siç referohet në Programin Rajonal të Vëzhguesve ICCAT (shtojca 6) dhe paragrafët 84 dhe 85, duhet të regjistrojë dhe raportojë mbi aktivitetet e transferimit të kryera, vëzhgojnë dhe vlerësojnë zëniet e transferuara dhe verifikojnë hyrjet të bëra në autorizimin paraprak të transferimit sipas paragrafit 86 dhe në deklaratën e transferimit të ICCAT siç referohet në paragrafin 87.

Në rastet kur ka më shumë se 10% diferencë nga numri ndërmjet vlerësimeve të bëra nga vëzhguesit rajonalë, autoritetet përkatëse të kontrollit dhe/ose zotëri i anijes peshkimit ose përfaqësuesi i kurthit, një hetim do të iniciohet nga CPC e anijes peshkimit, fermës ose kurthit dhe duke përfunduar para kohës së mbajtjes në kosha në fermë ose në çdo rast brenda 96 orëve nga fillimi, përveç rasteve të forcës madhore. Në pritje të rezultateve të këtij hetimi, hedhja në kosha nuk do të autorizohet dhe seksioni përkatës i BCD nuk do të vlerësohet.

Sidoqoftë, në rastet kur regjistrimi i videos është i cilësisë ose qartësisë së pamjaftueshme për të bërë vlerësime të tilla, operatori mund t'u kërkojë autoriteteve të CPC të anijes që të kryejnë një operacion të ri transferimi dhe t'ia japë regjistrimin përkatës në video vëzhguesit rajonal. Nëse ky kontroll vullnetar i transferimit nuk kryhet me rezultate të kënaqshme, CPC flamur do të fillojë një hetim. Nëse pas këtij hetimi vërtetohet se cilësia e videos nuk e lejon vlerësimin e sasive të përfshira në transferimin/vendosjen në kosha, autoritetet zbatuese të CPC të anijes peshkimit do të urdhërojnë një operacion të kontrollit të transferimit dhe të sigurojnë regjistrimin përkatës video për Observerin Rajonal. Transferimet e reja nuk do të kryhen si transferime kontrolli/kontroll i vendosjes në kosha, derisa cilësia e videos së regjistrimit mund të lejojë vlerësimin e sasive të transferuara.

93. Pa paragjykuar verifikimet e kryera nga inspektorët, vëzhguesi rajonal i ICCAT-it nënshkruan, me



emër të shkruar qartë dhe numrin ICCAT, deklaratën e transferimit të ICCAT vetëm kur vëzhgimet e tij/saj janë në përputhje me masat e ruajtjes dhe menaxhimit të ICCAT dhe se informacioni që përmbahet në të, është i pajtueshëm me vëzhgimet e tij/saj, duke përfshirë një video-regjistrim në përputhje me kërkesat në paragrafin 92. Ajo gjithashtu duhet të verifikojë që deklarata e transferimit të ICCAT-së të transmetohet te kapiteni i anijes rimorkiature ose përfaqësuesit të fermës/kurthit aty ku është e aplikueshme. Nëse nuk është dakord ai/ajo duhet të tregojë praninë e tij/saj në deklaratat e transferimit dhe BCDs dhe arsyet e mosmarrëveshjes duke cituar në mënyrë specifike rregullin(at) ose procedurën(at) që nuk janë respektuar.

Operatorët duhet të kompletojnë dhe të transmetojnë CPC të tyre deklaratën e transferimit të ICCAT në fund të operacionit të transferimit tek autoritetet e tyre përkatëse kompetente, në përputhje me formatin e paraqitur në shtojcën 4.

### **Aktiviteti i koshave**

#### **Autorizimet e vendosjes në kosha dhe refuzimi i mundshëm i një autorizimi**

94. Ndalohet ankorimi për çdo kosh transporti brenda një zone prej 0.5 miljeve detare nga fermat e kultivimit para fillimit të operacioneve të vendosjes në kosha. Për këtë qëllim, koordinatat gjeografike që korrespondojnë me zonën ku vendoset ferma e kultivimit duhet të jenë të disponueshme në planet e menaxhimit të fermave të transmetuara në ICCAT sipas paragrafit 24 të këtij rekomandimi.

95. Përpara çdo operacioni të vendosjes në kosha në një fermë, CPC-ja e anijes peshkimit ose kurthit duhet të informohet nga autoriteti kompetent i fermës CPC për sasinë e kapur nga anijet e peshkimit ose kurthet që mbajnë flamurin e saj.

Nëse CPC e anijes së peshkimit ose kurthit konsideron me marrjen e këtij informacioni se:

a) anija peshkimit apo kurthi, që ka deklaruar zënien e peshkut, nuk ka kuota të mjaftueshme të tonit të kuq për të vendosur në kosha;

b) sasia e peshkut nuk është raportuar në mënyrën e duhur nga anija peshkimit ose kurthi dhe nuk është marrë parasysh për llogaritjen e çdo kuote që mund të aplikohet; ose

c) anija peshkimit ose kurthi, që deklarojnë zënien e peshkut, nuk kanë një autorizim të vlefshëm për zënien e tonit të kuq, lëshuar në përputhje me paragrafin 54 të këtij Rekomandimi, CPC do të informojë autoritetet kompetente të shtetit ku ndodhet ferma, të bëjnë konfiskimin e zënieve dhe të bëjnë lëshimin e peshkut në det siç përshkruhet procedura në paragrafin 87 dhe shtojcën 10.

Aktiviteti i transferimit në kosha nuk do të fillojë pa pasur një konfirmim paraprak, brenda 24 orëve/1 ditë pune nga kërkesa, nga anija peshkimit ose kurth CPC, ose të autoriteteve të fermës nëse është rënë dakord me autoritetet e CPC-së. Nëse nuk merret përgjigje brenda 24 orëve/1 ditë pune nga autoritetet CPC të anijes peshkimit/kurthit, autoritetet e CPC të fermës mund të autorizojnë aktivitetin e vendosjes në kosha. Kjo nuk paragjykon të drejtat sovraane të fermës CPC.

Peshqit duhet të vendosen në kosha para datës 22 gusht, me përjashtim të rasteve kur ferma CPC që merr peshkun, jep arsye të vlefshme, duke përfshirë edhe forcën madhore, e cila duhet të shoqërojë raportin e vendosjes në kosha, kur paraqitet. Sidoqoftë, peshqit nuk duhet të vendosen në kosha pas 7 shtatorit.

#### **Dokumentacioni i zënies së tonit të kuq**

96. CPC, nën juridiksionin e së cilës ndodhet ferma e kultivimit të tonit të kuq, do të marrë masat e duhura për të ndaluar vendosjen në kosha për rritje apo majmëri të tonit të kuq, të cilat nuk janë të shoqëruara nga dokumentacioni i kërkuar nga ICCAT dhe që konfirmohen dhe vlerësohen nga autoritetet e CPC të anijeve të peshkimit dhe kurtheve të zënieve.

#### **Monitorimi nga video-kamera**

97. CPC, nën juridiksionin e së cilës ndodhet ferma, duhet të sigurojë që transferimi nga koshat për në fermat e kultivimit do të monitorohet nga autoritetet zbatuese të ligjit me video-kamera në ujë.

Një video-regjistruar do të prodhohet për secilin operacion të vendosjes në kosha, në përputhje me procedurat e shtojcës 8.

#### **Nisja dhe kryerja e hetimeve**

98. Në rastet kur ekziston një diferencë prej 10% më shumë në numër ndërmjet vlerësimeve të bëra nga vëzhguesi rajonal, autoritetet përkatëse të kontrollit dhe/ose operatori i fermës, një hetim do të iniciohet nga CPC e fermës në bashkëpunim me CPC e anijes dhe/ose kurthit të peshkimit, kur është e përshtatshme. CPC të fermave dhe të peshkimit që ndërmarrin hetimet mund të përdorin informata të tjera në dispozicion të tyre, duke përfshirë rezultatet e programeve të vendosjes në kosha, referuar në paragrafin 99 që përdorin sistemet e kamerave stereoskopike ose metodat alternative me kusht që të garantojnë të njëjtin nivel saktësie.

#### **Masat dhe programet për të vlerësuar numrin dhe peshën e tonit të kuq që futet në kosha**

99. Një program, i cili përdor sistemet e kamerave stereoskopike ose teknologjitë alternative që sigurojnë të njëjtën matjen me përpikmëri, do të mbulojë 100% të gjitha operacionet e vendosjes në kosha, me qëllim që të ripërcaktojë numrin dhe masën e peshkut. Ky program, që përdor kamera stereoskopike, duhet të kryhet në përputhje me procedurat e paraqitura në shtojcën 9. Në rastin e përdorimit të metodave alternative, këto metoda duhet të analizohen në mënyrë të duhur nga SCRS, i cili duhet të paraqesë konkluzionet e tij në lidhje me saktësinë e tyre për miratim nga Komisioni gjatë takimit vjetor para se një metodologji alternative të mund të konsiderohet e vlefshme për qëllime të monitorimit të operacioneve të vendosjes në kosha.

CPC-të e fermës do t'i komunikojnë rezultatet e këtij programi te CPC-të e zënieve dhe te vëzhguesi rajonal. Kur këto rezultate tregojnë se sasia e tonit të kuq që po mbahet në kosha ndryshon nga sasitë e raportuara të zëna dhe/ose të transferuara, duhet të fillojë një hetim. Nëse hetimi nuk përfundohet brenda 10 ditëve të punës nga njoftimi i vlerësuar me video nga kamera stereoskopike ose teknika alternative të kryera në përputhje me procedurat e paraqitura në aneksin 9, për një operacion të vetëm të zënies ose vlerësimin e plotë të të gjitha operacioneve nga një JFO, ose nëse rezultati i hetimit tregon se numri dhe/ose pesha mesatare e tonit të kuq është më i madh se ai i deklaruar në zënie dhe i transferuar, autoritetet e CPC-së të anijes peshkimit dhe/ose kurthit, lëshojnë një urdhër lirimi për tepricën, e cila duhet të lirohet në përputhje me procedurat e parashtruara në paragrafin 88 dhe shtojcën 10 dhe në prani të autoriteteve zbatuese të ligjit.

Sasitë që dalin nga programi do të përdoren për të vendosur nëse kërkohet lëshimi dhe deklaratat e zënies e pjesët përkatëse të BCD duhet të plotësohen në përputhje me këto të dhëna. Kur është lëshuar një urdhër lëshimi, operatori i fermës duhet të kërkojë praninë e një autoriteti zbatues kombëtar dhe një vëzhguesi të ICCAT për të monitoruar lëshimin.

Rezultatet e këtij programi do të dorëzohen deri më 15 shtator të çdo viti në SCRS nga të gjitha CPC-të e fermave. SCRS duhet të vlerësojnë këto procedura dhe rezultatet t'i raportojë në Komision në takimin vjetor në përputhje me shtojcën 9.

100. Transferimi i tonit të kuq nga një kosh në një tjetër nuk do të zhvillohet pa autorizimin dhe praninë e autoriteteve të kontrollit të fermës CPC. Çdo transferim regjistrohet numrin e mostrave. Autoritetet kombëtare të zbatimit e vëzhgimit sigurojnë që çdo transferim brenda fermës të regjistrohet në sistemin e-BCD.

101. Një ndryshim superior ose i barabartë me 10% midis sasive të tonit të kuq të raportuar të zënë nga anije/kurth dhe sasitë e vendosura nga aparati i kontrollit në momentin e mbylljes mund të pasqyrojë një mospërputhje të mundshme në fjalë dhe prandaj duhet të hetohet.

#### **Raporti i koshave**

102. CPC, nën juridiksionin e të cilit gjendet ferma për tonin e kuq, do të dorëzojë brenda një jave nga përfundimi i operacionit të vendosjes në koshave (një operacion nuk është i mbyllur plotësisht derisa të ketë mbaruar procesi i hetimit dhe i lëshimit), një raport për CPC e flamurit, i cili ka peshkuar tonin dhe Sekretariatit e ICCAT. Kur fermat e autorizuara për kultivimin e tonit të kuq, që është zënë në zonën e Konventës (më poshtë referuar si FFBs), janë vendosur jashtë ujërave nën juridiksionin e CPC-së, dispozitat e paragrafit të mëparshëm zbatohen pjesë-pjesë në CPC ku ndodhen personat fizik ose juridik përgjegjës për FFB.

#### **Transferimet brenda fermës dhe kontrollet e rastit**

103. Një sistem gjurmues do të kërkohet në fermat e kultivimit që do të përfshijë video-regjistrimet e transferimeve të brendshme. Mbi bazat e një analize risku, kontrollet e rastit do të ndërmerren nga autoritetet kontrolluese të CPC së fermës së tonit të kuq midis kohës së përfundimit të operacioneve të vendosjes në kosha dhe vendosjes së parë në kosh në fillim të vitit pasardhës. Çdo CPC do të caktojë një përqindje minimale të peshkut për t'u kontrolluar, e cila do të pasqyrohet në planin e tij të kontrollit të në përputhje me paragrafin 14 të këtij Rekomandimi. Rezultatet e këtyre kontrolleve do t'i komunikohen ICCAT-it në prill të vitit pasardhës të periudhës së kuotave korresponduese.

#### **Qasja dhe kërkesat për regjistrimet video**

104. Çdo CPC do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që të dhënat nga video-regjistrimet, sipas paragrafëve 97 dhe 99, të vihen në dispozicion të inspektorëve kombëtarë, rajonalë dhe të ICCAT, si dhe në dispozicion të vëzhguesve të ICCAT dhe të CPC-ve, sipas kërkesës.

Çdo CPC do të vendosë masat e nevojshme për të shmangur çdo zëvendësim, transmetim ose manipulim të regjistrimit video origjinal.

**Pjesa IV**  
**Masat e kontrollit**  
**Seksioni E - Ndjekja e aktiviteteve**  
**të peshkimit**

**VMS**

105. CPC do të zbatojnë një sistem të monitorimit të anijeve për anijet e tyre të peshkimit me një gjatësi të barabartë ose më të madhe se 15 m, në përputhje me Rekomandimin e ICCAT në lidhje me standardet minimale për një Sistem të Vëzhgimit të Anijeve në Zonën e Konventës të mbuluar nga ICCAT (Rec. 18-10).

Sekretari Ekzekutiv i ICCAT do të bëjë të disponueshëm pa vonesë informacionin në lidhje me këtë pikë të CPC që ka një prani aktive të inspektimit në zonën e planifikuar dhe tek SCRS, sipas kërkesës së saj.

Me kërkesë të CPC-ve të përfshirë në inspektimin e aktivitetit në zonën e Konventës, në përputhje me skemën ICCAT për inspektimin e përbashkët ndërkombëtar referuar në paragrafët 109 deri 112 të këtij Rekomandimi, Sekretariati i ICCAT do të bëjë të disponueshëm mesazhet e marra nga të gjitha anijet e peshkimit, sipas paragrafit 3 të Rekomandimit të ICCAT. Format e ndryshme të mbledhjes së të dhënave dhe protokollit në lidhje me Sistemin e Monitorimit të Anijeve (VMS) për peshkun ton në zonën e Konventës ICCAT [Rec. 07-08].

Transmetimi i të dhënave të VMS nga anijet e peshkimit me gjatësi mbi 15 m të përfshira në regjistrat e ICCAT si anije “zëniat” dhe “të tjera”, do të fillojë të paktën 5 ditë përpara periudhës së autorizuar dhe do të vazhdojë të paktën 5 ditë pas kësaj periudhe të autorizuar, përveçse nëse anija është larguar nga listat e anijeve të autorizuar nga autoriteti i saj CPC.

Për qëllime kontrolli, transmetimi i VMS nga anijet e peshkimit të autorizuar për peshkimin e tonit të kuq nuk do të ndërpritet kur anijet janë në port, përveçse nëse ekziston një sistem thirrjeje brenda dhe jashtë portit.

Sekretariati i ICCAT do të informojë sa më shpejt CPC-të për mosmarrje apo për shtyrje afati të transmetimeve të VMS dhe do të shpërndajë raporte mujore të gjithë CPC-ve me informacion specifik mbi natyrën dhe qëllimin e këtyre vonesave. Raporte të tilla do të jenë javore gjatë periudhës 1 maj deri në 30 korrik.

**Pjesa IV**  
**Masat e kontrollit**  
**Seksioni F – Zbatimi**

**Zbatimi**

106. CPC-të marrin masat e duhura të zbatimit të ligjit për një anije peshkimi, aty ku është vendosur, në përputhje me ligjin e saj, që anija peshkimi që mban flamurin e saj nuk është në përputhje me dispozitat e këtij rekomandimi.

Masat do të jenë në përpjesëtim me rëndësinë e veprës dhe në përputhje me dispozitat përkatëse të së drejtës kombëtare, në mënyrë të tillë që të sigurojnë se në mënyrë efektive privojnë ata që janë përgjegjës për përfitimin ekonomik që rrjedh nga shkeljet e tyre, pa paragjykuar ushtrimin e profesionit të tyre. Këto sanksione duhet të jenë gjithashtu në gjendje të japin rezultate proporcionale me seriozitetin e një shkelje të tillë, duke dekurajuar në mënyrë efektive shkeljet e mëtejshme të të njëjtit lloj.

107. CPC, nën juridiksionin e së cilës ndodhet ferma për tonin e kuq, do të marrin masat e duhura të zbatimit në lidhje me një fermë, ku ajo është vendosur, në përputhje me ligjin e saj, se kjo fermë nuk është në përputhje me dispozitat e paragrafëve 94 deri 104.

Masat mund të përfshijnë veçanërisht në varësi të rëndësisë së veprës dhe në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit kombëtar, pezullimin ose tërheqjen e regjistrimit të fermave të tonit të kuq, së bashku me gjobat.

**Pjesa IV**  
**Masat e kontrollit**  
**Seksioni G - Masat e tregut**

108. Në përputhje me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ligjet ndërkombëtare, CPC eksportues dhe importues do të marrë masat e nevojshme që:

- të ndalojnë tregtimin në tregun e brendshëm, zbarkimin, importimin, eksportimin, vendosjen në kosha

për kultivim, rieksporimin dhe transbordimin e individëve të tonit të kuq të Atlantikut Lindor dhe të Detit Mesdhe që nuk janë të shoqëruar me dokumentacionin e plotë, të saktë dhe të certifikuar të kërkuar nga ky Rekomandim dhe Rekomandimi i ICCAT-it, që zëvendëson Rekomandimin 11-20 në lidhje me Programin e Dokumentacionit të Zënies të Tonicit të ICCAT (Rec. 18-13) dhe Rekomandimin nga ICCAT që zëvendëson Rekomandimin 17-09 mbi Zbatimin e Sistemit eBCD (Rec. 18-12) për Programin e Dokumentimit të Zënies të Tonicit.

- të ndalojë tregtimin në tregun e brendshëm, importimin, zbarkimin, vendosjen në kosha për kultivim, përpunimin, eksportimin, rieksporimin dhe transbordimin brenda juridiksionit të tyre të individëve të tonit të kuq të Atlantikut Lindor dhe Mesdheut të zëna nga anijet e peshkimit ose kurthet, CPC-të e të cilëve nuk kanë kuota, kufi zëniesh apo alokim të sforcos së peshkimit për këtë lloj, nën masat konservuese dhe menaxhuese të ICCAT, ashtu dhe në rastin kur mundësitë e peshkimit të CPC kanë mbaruar, apo kur kuotat individuale të anijes peshkuese, parashikuar në paragrafin 4, kanë mbaruar;

- të ndalojë tregtimin në tregun e brendshëm, importimin, zbarkimin, përpunimin, eksportimin nga fermat e kultivimit që nuk janë në përputhje me Rekomandimet e ICCAT për Kultivimin e Tonicit të Kuq [Rec. 06-07].

## **Pjesa V**

### **Skema ICCAT e Inspektimit të Përbashkët Ndërkombëtar**

109. Në kuadër të planit të menaxhimit shumëvjeçar për tonin e kuq, çdo CPC bie dakord, në përputhje me nenin IX, pika 3 të Konventës së ICCAT, për ta aplikuar skemën e ICCAT për inspektimin e përbashkët ndërkombëtar të adoptuar gjatë takimit të 4 të zakonshëm, të mbajtur në nëntor 1975 në Madrid, siç është ndryshuar në shtojcën 7.

110. Skema e parashikuar në pikën 109 do të aplikohet derisa ICCAT të adoptojë një skemë kontrolli, vëzhgimi, mbikëqyrjeje e cila do të përfshijë një skemë të ICCAT për inspektimin e përbashkët ndërkombëtar, bazuar në rezultatet e grupit të punës për masat e integruara monitoruese, përcaktuar nga Rezoluta për Masat e Monitorimit të Integruar [00-20].

111. Kur në çdo kohë, më shumë se 15 anije peshkimi nga cilado palë kontraktuese angazhohen në veprimtaritë e peshkimit të tonit në Atlantikun Lindor e në Mesdhe në zonën e Konventës, pala Kontraktuese, në bazë të vlerësimit të rrezikut, duhet të ketë një anije inspektimi në zonën e Konventës, ose duhet të bashkëpunojë me një palë tjetër Kontraktuese për operuar një anije inspektimi. Nëse një palë kontraktuese nuk vendos anijen e vet inspektuese ose nuk kryen operacione të përbashkëta, pala kontraktuese do të raportojë rezultatin e vlerësimit të rrezikut dhe masat alternative të tij në planin e tij të inspektimit të referuar në paragrafin 14.

112. Në rastet kur masat zbatuese duhet të merren si rezultat i një inspektimi, kompetencat zbatuese të inspektorëve të palës kontraktuese të flamurit të anijes, fermës ose kurthit të peshkimit, subjekt i inspektimit, gjithmonë mbizotërojnë në territorin e tyre, ujërat e tyre juridike dhe/ose në bordin e platformës së tyre të inspektimit.

## **Pjesa VI**

### **Dispozitat përfundimtare**

#### **Disponueshmëria e të dhënave në SCRS**

113. Sekretariati i ICCAT do t'i sigurojë SCRS të gjitha të dhënat e marra në përputhje me këtë Rekomandim. Të gjitha të dhënat do të trajtohen në mënyrë konfidenciale.

#### **Masat mbrojtëse**

114. Kur si rezultat i një vlerësimi shkencor qëllimi i ruajtjes së biomasës rreth B 0.1 (të jenë të arritura nga peshkimi në ose më pak se F 0.1) nuk është arritur dhe objektivat e këtij plani janë në rrezik, SCRS propozon një Këshillë të re për TAC për vitin e ardhshëm.

#### **Klauzola e rishikimit**

115. Për herë të parë më 2020-n dhe, në çdo rast, pas vlerësimit të rezervës për tonin e kuq në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe, që konfirmon rimëkëmbjen e plotë të rezervës, Komisioni, duke ndjekur këshillat shkencore të ofruara nga SCRS, vendos për vazhdimësinë e këtij plani të menaxhimit ose në një rishikim të mundshëm të rregullave të përcaktuara aty.

116. Pavarësisht nga paragrafi 115, një grup pune ndër-sesional i panelit 2 të ICCAT do të ngrihet çdo vit në mars në qëllim që të:

a) të miratojë planet vjetore të peshkimit, planet vjetore të kapaciteteve, planet e kultivimit dhe të

inspektimit të dërguara në ICCAT sipas paragrafit 14 të këtij Rekomandimi;

b) të diskutojë çdo dyshim të mundshëm në lidhje me interpretimin e këtij Rekomandimi dhe bërjen e draft-amendamenteve të këtij rekomandimi që do të diskutohen në mbledhjen e komisionit vjetor.

c) të diskutojë masa potenciale shtesë për forcimin e mëtejshëm të gjurmuesmërisë së tonit të kuq të gjallë.

#### **Vlerësimi**

117. Të gjitha CPC-të duhet të paraqesin me kërkesë të Sekretariatit rregulloret dhe dokumentet e tjera përkatëse të miratuara prej tyre për zbatimin e këtij Rekomandimi. Në mënyrë që të ketë transparencë më të madhe në zbatimin e këtij Rekomandimi, Sekretariati i ICCAT do të përgatisë çdo dy vjet një raport mbi zbatimin e këtij Rekomandimi.

#### **Përfundimet për CPC-të me detyrim zbarkimin e tonit të kuq**

118. Dispozitat në këtë rekomandim, që ndalojnë mbajtjen në bord, transbordimin, transferimin, zbarkimin, transportimin, magazinimin, shitjen, shfaqjen ose ofrimin për shitjen e tonit të kuq, nuk zbatohen për CPC-të me një legjislacion të brendshëm të para vitit 2013, duke kërkuar që të gjitha peshqit e ngordhur të zbarkohen, me kusht që vlera e një peshku të tillë të konfiskohet për të parandaluar që peshkatarët të kenë ndonjë përfitim komercial nga peshqit e tillë. CPC duhet të marrin masat e nevojshme për të parandaluar eksportimin e peshkut të konfiskuar në CPC të tjera. Sasitë e tonit të kuq të cilat tejkalojnë kuotat e alokuara për CPC, në përputhje me këtë derogim do të zbriten vitin pasardhës nga kuota e CPC-së.

#### **Shfuqizime**

119. Ky Rekomandim shfuqizon Rekomandimin nga ICCAT që ndryshon Rekomandimin 14-04 për tonin e kuq në Atlantikun Lindor dhe Mesdhe (Rec. 17-07).

## **SHTOJCA 1**

### **Kushtet specifike që aplikohen për anijet e peshkimit të parashikuara në paragrafin 35**

1. CPC duhet të kufizojnë:

- numrin maksimal të barkave me grepa (*baitboat* dhe *trolling boat*) të autorizuar për të peshkuar në mënyrë aktive tonin e kuq me numrin e anijeve që kanë marrë pjesë në peshkimin direkt për tonin e kuq gjatë vitit 2006;

- numrin maksimal të anijeve të saj artizanale të autorizuar për të peshkuar në mënyrë aktive tonin e kuq në Mesdhe me numrin e anijeve që kanë marrë pjesë në peshkimin e tonit të kuq në 2008-n;

- numrin maksimal i anijeve peshkuese të autorizuar për të peshkuar në mënyrë aktive tonin e kuq në detin Adriatik me numrin e anijeve që kanë marrë pjesë në peshkimin e tonit të kuq gjatë vitit 2008. Çdo CPC do t'i alokojë kuota individuale anijeve në fjalë.

CPC do të lëshojë autorizime specifike për anijet e cilësuar në paragrafin 1 të kësaj shtojce. Këto anije duhet të tregohen në listën e anijeve që peshkojnë të treguar në paragrafin 49 (a) të këtij rekomandimi, atëherë kur zbatohen kushtet për ndryshim.

2. Çdo CPC do të alokojë jo më shumë se 7% të kuotave të saj për tonin e kuq për barkat me grepa (*baitboat* dhe *trolling boat*).

3. Çdo CPC mund të alokojë jo më shumë se 2% të kuotave të saj për tonin e kuq për peshkimin artizanal bregdetar të peshkut të gjallë në Mesdhe.

Çdo CPC mund të alokojë jo më shumë se 90% të kuotave të saj për anijet peshkuese në Adriatik për qëllime kultivimi.

4. CPC-të, anijet me grepa, linje grepash, grepa dore dhe grepa tërheqës të cilave janë të autorizuar të peshkojnë tonin e kuq në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe duhet të përcaktojnë kërkesat për shënjimin e bishtit si më poshtë:

a) shenjimi i bishtit duhet të fiksohet në çdo ton të kuq të peshkuar menjëherë pas nxjerrjes nga uji;

b) çdo shenjë e bishtit duhet të ketë një numër unik identifikimi që duhet të përfshihet në dokumentin e zënies dhe shkruar lexueshëm në pjesën e jashtme të çdo paketimi që përmban ton.

## **SHTOJCA 2**

### **A – Anijet e peshkimit**

#### **Specifikimet minimale për librin e anijes**

1. Libri i anijes duhet t'i ketë faqet e numëruara.

2. Libri i anijes duhet të plotësohet çdo ditë (mesnatë) ose përpara mbërritjes në port.

3. Libri i anijes duhet të plotësohet në rastet e inspektimit në det.
4. Njëra nga kopjet e faqeve duhet të mbetet e ngjitur në librin e anijes.
5. Libri i anijes duhet të mbahet në bord, në mënyrë që të mbulojë aktivitetin e kryer gjatë një viti.

#### **Informacionet minimale standarde në librin e anijes**

1. Emri dhe adresa e kapitenit.
  2. Data dhe porti i nisjes, data dhe porti i mbërritjes.
  3. Emri i anijes, numri i regjistrit, numri i ICCAT, sinjali i thirrjes ndërkombëtare në radio dhe numri IMO (nëse ka).
  4. Veglat e peshkimit:
    - a) lloji i kodit sipas FAO;
    - b) madhësia (gjatësia, madhësia e syzeve, numri i grepave...).
  5. Aktiviteti në det me një rresht (minimumi) për ditë peshkimi, duke dhënë:
    - a) aktivitetin (peshkimin, lundrimin...);
    - b) pozicionin: pozicioni ekzakt ditor (në gradë dhe minuta), regjistruar për çdo aktivitet peshkimi ose në mesditë kur nuk ka pasur peshkim gjatë ditës;
    - c) regjistrimin e zënieve, i cili përfshin:
      - i. kodin e FAOs;
      - ii. peshën e rumbullakosur (RWT) në kilogramë për ditë;
      - iii. numrin e individëve për ditë.
- Për anijet e peshkimit me rrethim (koshilok) kjo duhet të regjistrohet për çdo operacion peshkimi duke përfshirë edhe kthimet bosh.
6. Siglën e kapitenit.
  7. Mënyrën e matjes së peshës: vlerësimi, peshimi në bord, numërimi;
  8. Libri i anijes mbahet në peshë të gjallë ekuivalente peshku dhe përmendet faktori i konversionit i përdorur në vlerësim.

#### **Minimumi i informacionit në librin e anijes në rast zbarkimi ose transbordimi**

1. Data dhe porti i zbarkimit, transbordimit/transferimit.
2. Produkti:
  - a) speciet dhe paraqitja sipas kodit FAOs;
  - b) numri i individëve apo i kutive dhe sasia në kilogramë;
3. Sigla e kapitenit apo e agjentit të anijes.
4. Në rastin e një transbordimi, emrin e anijes marrëse, flamurin e saj dhe numrin ICCAT.

#### **Minimumi i informacionit për librin e anijes në rastin e transferimit në kosha:**

